UDHËZIM
Nr.5, datë 30.1.2006

PËR TATIMIN MBI TE ARDHURAT

(ndryshuar me udhëzimet: nr. 3, datë 7.1.2011; nr. 9, datë 26.4.2011; nr. 13, datë 26.5.2011; nr. 24, datë 7.11.2011; nr. 16, datë 25.7.2012; nr. 10, datë 25.2.2013; nr. 14, datë 24.5.2013; nr. 23, datë 30.7.2013; nr. 31, datë 29.12.2014; nr. 4, datë 21.2.2019; nr. 12, datë 15.3.2019, nr. 36, datë 21.9.2020)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqiperise, si dhe në zbatim të nenit 40 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Objekti i ligjit

Objekt i tatimit mbi të ardhurat janë të ardhurat personale të individeve, fitimi i personave fizikë e juridikë subjekte të këtij Ligji, si dhe të ardhurat për të cilat tatimi mbahet në burim.

1.2 PËRKUFIZIM

1.2.1 Termat: "tatimpagues", "person", "individ", "person fizik", "person juridik", "ortakëri", "persona të lidhur" dhe "seli e përhershme", etj, kuptimi i të cilave jepet në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", do të kenë të njëjtin kuptim si edhe në ligjet e tjera specifike tatimore dhe në terminologjinë e përdorur në Marrëveshjet dypalëshe për eliminimin e tatimeve të dyfishta që Shqipëria ka lidhur me shtete të tjera. Për interpretimin e dispozitave të këtij ligji, veç këtij Udhëzimi, do të merren në konsiderate, sipas rastit, edhe dizpozitat e ligjeve të tjera tatimore dhe të Marrëveshjeve për eleminimin e tatimeve të dyfishta, si dhe të Udhëzimeve të Ministrit të Financave të dala në zbatim të tyre.

1.2.2. Paragrafi "2" i nenit "2" të Ligjit, sqaron kuptimin e "selisë së përhershme", e cila nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet së cilit një person (juridik apo fizik) i huaj ushtron biznes në Republikën e Shqipërisë pa qenë i regjistruar si person juridik apo fizik sipas legjislacionit Shqiptar. Përkufizimi i "selisë së përhershme" është i ngjashëm me përkufizimin e këtij koncepti nga "Modeli i Konventës Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin" botim i OECD-së, Prill 2000, si edhe me përkufizimin e këtij termi në Marrëveshjet Bilaterale Tatimore për Eleminimin e Tatimeve të Dyfishta të hyra ne fuqi ne Shqiperi. Për pasojë në interpretimin e dispozitave që lidhen me selinë e përhershme do të merren në konsideratë edhe sqarimet e bëra në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.6 datë 10.2.2004 "Për Marrëveshjet Bilaterale për Shmangien e Taksimimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal".

Në rastet kur një biznes plotëson kushtet për t'u konsideruar si seli e përhershme (vend fiks biznesi) në Republikën e Shqipërisë, atëhere të ardhurat që i atribuohen kësaj selie të përhershme tatohen në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave te akteve ligjore mbi tatim fitimin.

1.3 REZIDENCA

1.3.1 Në paragrafin e parë të pikës 1 të nenit 3 të ligjit, jepet kriteri i vendbanimit të përhershëm, sipas përcaktimit në nenin 12 të Kodit Civil. Individi konsiderohet rezident shqiptar për qëllime tatimore, kur ka një banesë të përhershme, ka familjen, pra ka interesa jetësorë dhe ekonomikë në Shqipëri (vendi i interesave jetikë), pavarësisht se mund të punojë në periudha të ndryshme jashtë vendit apo mund të ketë nënshtetësi të huaj.

1.3.2 Paragrafi i dytë i pikës 1 të nenit 3 të ligjit përcakton rezidencën e funksionarit konsullor, diplomatik ose të ngjashëm, të caktuar me punë nga shteti në ambasada, konsullata apo në organizma ndërkombëtarë jashtë vendit, të cilët konsiderohen rezidentë tatimorë shqiptarë edhe pse jetojnë me vite jashtë Shqipërisë.

1.3.3 Në pikën 2 të nenit 3 të ligjit jepet kriteri i kohës së qëndrimit në Shqipëri. Pra konsiderohet rezident shqiptar për qëllime tatimore, individi i cili qëndron në Shqipëri gjatë një viti tatimor, në vazhdim ose me ndërprerje, në total, më tepër se 183 ditë, pavarësisht nga shtetësia apo vendi ku ka interesat jetikë. Në llogaritjen e kohës së qëndrimit në Shqipëri përfshihen ditët e prezencës fizike, pra jo vetëm ditët e punës por edhe ditët e mbërritjes, largimit, pushimet. Konsiderohet rezident tatimor shqiptar çdo individ që plotëson njërin ose të dyja kriteret e sipërpërmendura (kriterin e vendbanimit dhe kriterin e kohës së qëndrimit).

1.3.4 Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit, jepen kriteret e përcaktimit të rezidencës tatimore për personat juridikë. Një person juridik konsiderohet rezident tatimor shqiptar nëse:

i) ka selinë qendrore (zyrën qendrore) në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose

ii) ka vendin e menaxhimit (drejtimit) efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.

1.3.5 Në pikën 4 të nenit 3 të ligjit jepet kriteri i përcaktimit të rezidencës tatimore për personat fizikë tregtarë. Një person fizik konsiderohet rezident tatimor shqiptar kur ushtron biznesin dhe regjistrohet si person fizik tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1.3.6 Përcaktimi i rezidencës tatimore ka rëndësi, pasi në bazë të paragrafit 1 të nenit 7 dhe paragrafit 1 të nenit 17 të ligjit, personat rezidentë tatimorë shqiptarë tatohen në Shqipëri për të gjitha të ardhurat e realizuara në shkallë botërore (të ardhurat me burim në Shqipëri dhe jashtë saj), ndërsa personat jorezidentë, në bazë të paragrafit 2 të nenit 7 dhe paragrafit 2 të nenit 17, tatohen në Shqipëri vetëm për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë.

1.3.7 Duhet pasur parasysh që për personat që janë rezidentë në vendet me të cilat Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe këto marrëveshje kanë hyrë në fuqi, do të zbatohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve.

1.3.8 Organi tatimor pas paraqitjes së kërkesës me shkrim, pajis rezidentin (individ, person fizik apo juridik) në Republikën e Shqipërisë me certifikatën e rezidencës, sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi. Rezidenti individ pajiset me certifikatën e rezidencës sipas modelit R/I nr. 1 dhe rezidenti person fizik apo juridik pajiset me certifikatën e rezidencës sipas modelit R/I nr. 2 nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

1.4 BURIMI I TË ARDHURAVE

1.4.1 Përcaktimi i "burimit të të ardhurave" është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor të personave rezidentë dhe sidomos për personat jorezidente, të cilët tatohen në Shqipëri për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë. Në Nenin 4 të Ligjit Nr.8438 datë 28/12/1998, i ndryshuar, "Për tatimin mbi të ardhurat" listohen të gjitha të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë, por duke mos u kufizuar vetëm në atë listë. Për të përcaktuar të ardhurat me burim në Shqipëri të personave jo rezidentë, mënyra më e lehtë është identifikimi i pagesave që bëhen nga persona rezidentë tatimorë shqiptarë apo nga çdo ent, organ të qeverisjes qendrore dhe vendore, etj. Organi tatimor mund të shfrytëzojë, reklamat, njoftimet në gazeta apo media, informacionet nga bankat apo nga burime të tjera për të identifikuar të ardhurat e realizuara me burim në Shqipëri. Kur këto të ardhura realizohen nga persona jo-rezidentë, apo nga individë apo persona rezidentë shqiptarë që, në bazë të legjislacionit tatimor ekzistues, nuk janë të detyruar të regjistrohen në organet tatimore shqiptare, detyrimi tatimor do të mbahet në burim nga paguesi i të ardhurave. Në pamundësi për këtë, përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë detyrimin tatimor në organin tatimor përkatës.

1.4.2 Të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë konsiderohen edhe të ardhurat e paguara nga një person (shoqëri, ent, individ, fondacion etj.) jashtë Shqipërisë (jo rezident) por të realizuara për një aktivitet të kryer në Republikën e Shqipërisë (p.sh. një koncert i një artisti në Shqipëri i paguar nga një fondacion i huaj). Pra, në këtë rast, është i rëndësishëm vendi ky kryhet aktiviteti dhe jo vendi ku kryhet pagesa.

1.4.3 Paragrafi "dh", i nenit 4 të ligjit sqaron se të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat për shfrytëzimin e resurseve dhe të mirave natyrore shqiptare, konsiderohen me burim në Shqipëri, janë të tatueshme në Shqipëri dhe do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e tjera nga pasuria e paluajtshme. Këto të drejta në veçanti përfshijnë licencat dhe marrëveshjet që lejojnë nxjerrjen e mineraleve, apo të naftës dhe gazit. Gjithashtu, të ardhurat që sigurohen nga informacionet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me këto të drejta, janë objekt i parashikimeve të paragrafit "dh". Shembull: informacioni sizmik, informacione të tjera teknike dhe analiza që mund të disponohen në lidhje me ekzistencën e burimeve natyrore, p.sh., naftës, gazit, kromit etj., informacione të cilat transferohen te palët e treta.

1.4.4 Paragrafi "e' i nenit 4 trajton si të ardhura me burim në Shqipëri, të ardhurat nga tjetërsimi i të drejtave objekt i paragrafit "dh" të nenit 4. Nënpika "i" e paragrafit "e" mbulon veçanërisht përfitimet nga shitja e drejtpërdrejtë e të drejtave për të shfrytëzuar burimet natyrore, apo informacionit që u përket të drejtave të tilla. Nënpika "ii" e paragrafit "e" mbulon shitjet indirekte të aksioneve, të drejtave dhe informacionit të mbuluara nga paragrafi "dh". Ajo bazohet në parimet e nenit 13(4) të Modelit të tatimit mbi të ardhurat të Konventave të OECD-së dhe OKB-së. Fitimet nga shitja e aksioneve (ose interesave të ngjashëm) që rrjedhin nga pasuria, të drejtat ose informacionet e përmendura në paragrafin "dh" trajtohen si me burim në Shqipëri. Megjithatë, duhet që këtyre aksioneve të paktën 50 për qind e vlerës së tyre t'iu burojë nga pasuria, të drejtat ose informacioni në fjalë. Këto parashikime janë të rëndësishme kryesisht për shit/blerjet e aksioneve ndërmjet personave jorezidentë shqiptare, në lidhje me pasuri dhe të drejta të vendosura në Shqipëri, ndërkohë që, rezidentët shqiptare tatohen për të gjithë të ardhurën në baza mbarëbotërore.

1.5 PERIUDHA TATIMORE

Periudha tatimore përputhet me vitin kalendarik, pra fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31

Dhjetor të çdo viti.

2. TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

2.1 FUSHA E VEPRIMIT TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE.

Tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin te gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara nga ligji.

2.2 SHTRIRJA E DETYRIMIT

Në Nenin 7 "Shtrirja e detyrimit" jepet parimi i përgjithshëm sipas të cilit individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave (brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), ndërsa individët jorezidente i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të ardhurat me burim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2.3 TË ARDHURAT E TATUESHME

Në zbatim të nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:

2.3.1 Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi). Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblime të tjera në vlerë që lidhen me punësimin aktual të individit. Në të ardhura nga pagat përfshihet paga bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm si shtesat për vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të bëra me akte të tjera ligjore e nënligjore.

Termi "shpërblime të tjera" përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që merr individi në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statutore të shoqërive, si pagë e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre.

Në grupin "shpërblime të tjera" përfshihen gjithashtu të ardhura që realizohen nga pjesëmarrja e individit në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse, etj. Në këto raste mënyra e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do të jetë si më poshtë:

a) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse etj., paguhet jashtë qendrës efektive të punës së individit, këto të ardhura tatohen në masën *15 për qind*;

b) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të tatohen duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës, sipas tabelës nr. 1 bashkengjitur Ligjit.

Shembull: Supozojmë se individi "X", i cili është i punësuar në subjektin "Y", gjatë muajit *Janar 2019* ka përfituar këto të ardhura:

- Pagën bazë mujore (përfshirë pjesën e kontributit për sigurime shoqërore dhe shëndetsore që është përballuar nga punëmarrësi) 45.000 lekë;
- Shpërblim nga fondi i veçantë 20.000 lekë;
- Shpërblim prej 15.000 lekë, si anetar i Bordit Drejtues të subjektit "Y";
- Shpërblim prej 5.000 lekë nga pjesëmarrja në një komision testimi të subjektit "Y", i cili mblidhet dy herë në vit;
- Individi X është shpërblyer gjithashtu me 10.000 lekë, nga pjesëmarrja në një Komision Testimi të subjektit "Z";
- Individi X është shpërblyer gjithashtu me 8.000 lekë për një artikull që ka shkruar në një revistë të huaj.

Detyrimi tatimor për të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e tjera për muajin Dhjetor 2003 për individin "X" do të jetë:

- 45.000 (paga bazë +shtesat) + 20.000 (shpërblimi nga fondi i veçantë) + 15.000 (shpërblimi si anëtar i bordit drejtues) + 5.000 (shpërblim nga pjesmarrja në Komisionin e testimit) = 85.000 lekë. Kjo shumë do të tatohet me tatim në burim sipas tarifave progresive të Tabelës nr.1 bashkangjitur Ligjit.

Për shpërblimin e marrë nga individi X nga pjesëmarrja në Komisionin e Testimit të subjektit "Z", detyrimi tatimor është 15 për qind, ose 1500 lekë (10.000 x15 %), tatim që mbahet në burim nga subjekti "Z";

Për të ardhurat e përfituara nga revista e huaj prej 8.000 lekë individi X duhet të deklarojë në organin përkatës

tatimor dhe të derdhë një tatim në masën 15%, pra 1200 lekë.

2.3.2 Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale, të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdheniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatëve, ose funksionarëve të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat apo marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranuara nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk do të përfitojnë të drejtën e këtij përjashtimi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët mund të jenë të punësuar në këto organizata apo organizma, por nuk kanë statusin e diplomatit.

2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (Pika b e paragrafit 1).

Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividentit nga shoqëritë tregtare dhe subjekte të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

2.3.4 Të ardhurat nga interesat bankare, apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose nga letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emetuara para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Të ardhura nga interesat bankare konsiderohen të gjitha interesat nga llogaritë personale apo të përbashkëta të individëve, në banka ose në institucione të tjera financiare, si dhe të gjitha interesat nga depozitat personale ose të përbashkëta me afat, në formën e llogarisë me afat, çertifikatës së depozitës me afat, kontratës për depozitë me afat, si dhe çdo e ardhur tjetër në formë interesi.

Tatimit mbi të ardhurat i nënshtrohen të gjitha interesat e lindura dhe të paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, për llogaritë dhe depozitat në lekë dhe në valutë. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe depozitat me afat maturimi më të gjatë se një vit. Tatimi mbi të ardhurat nga interesat në valutë konvertohet në lekë, me kursin mesatar të këmbimit të aplikuar nga vetë banka për blerjen e valutave respektive, në ditën e kryerjes së veprimit.

Moment i pagimit të interesave konsiderohet dita e pagimit të interesave në "cash" ose dita e maturimit apo rikapitalizimit të tyre. Bankat apo institucionet e tjera financiare do të llogarisin, deklarojnë dhe paguajnë në organin tatimor përkatës tatimin mbi interesat jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës, maturimit apo rikapitalizimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për tatimin mbi interesat për llogaritë e mbyllura.

Për të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit apo letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria në tregun primar dhe të përfituara nga çdo person, tatimi llogaritet, deklarohet dhe paguhet nga Banka e Shqipërisë jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të pagesës.

Tatimi në burim nuk mbahet kur përfitues i interesave është një person juridik apo person fizik tregtar i rregjistruar në organet tatimore dhe subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar dhe i tatimit mbi fitimin dhe të ardhurat nga interesat përfshihen në të ardhurat e tatueshme të përfituesit. Në këto raste depozita apo bonot e thesarit apo letrat me vlerë në lidhje me të cilat paguhen interesat duhet të jetë në emër të personit juridik.

Bankat apo institucionet e tjera financiare mbajnë evidencë për interesat e paguara, llogarisin, deklarojnë dhe paguajnë në administratën tatimore, jo më vonë se data 20 e çdo muaji për interesat e paguara dhe tatimin e mbajtur në burim për muajin paraardhës.

2.3.5 Të ardhurat e përfituara nga pagesat për të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale.

Këto janë të ardhura që lindin nga përdorimi apo e drejta për të përdorur të drejtat e autorit në letërsi, art, muzikë apo shkencë, që përfshijnë përdorimin apo të drejtën për të përdorur filmat kinematografikë, filmat dhe regjistrime të ndryshme për radio apo TV, çdo patentë, markë tregtare, skicë apo model, projekt, formulë sekrete, informacion apo proçes teknollogjik, lidhur me aktivitete industriale, tregtare apo shkencore.

2.3.6 Të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qeratë (pika d).

Me termin "enfiteozë" do të kuptohet kontrata me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorë dhe të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, sipas përkufizimit të nenit 784 e vijues të Kodit Civil. E ardhur nga enfiteoza do të konsiderohet shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë që i paguhet pronarit të pasurisë së paluajtshme nga personi që e merr pronën në përdorim. Në rastet kur marrësi në përdorim, sipas kontratës midis palëve, kryen shpenzime për përmirësimin dhe përshtatjen e kësaj pasurie për nevojat e tij, atëherë këto shpenzime do të konsiderohen si të ardhura për individin pronar të objektit dhe do të tatohen sikur të ishin e ardhur nga enfiteoza.

E ardhur nga huaja do të konsiderohet çdo e ardhur e përfituar nga dhënia në formën e huasë e mjeteve monetare apo të mjeteve të tjera të ngjashme me to.

Të ardhura nga qeraja do të konsiderohen të gjitha të ardhurat e përfituara nga dhënia me qera e tokës, ndërtesave e objekteve të tjera që shërbejnë për banim, aktivitet industrial, tregtar, shërbimi etj., por pa u kufizuar vetëm në to.

Llogaritja e detyrimit tatimor për këtë kategori të ardhurash do të bëhet duke u bazuar në kontratën përkatëse.

2.3.7 Të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme (pika "dh" të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.).

Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme ose vlera e tregut e pasurive të paluajtshme të dhuruara. Këto të ardhura tatohen sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme

2.3.8 Të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave të pjesëmarrjes në kapital apo të aksioneve.Në këtë grup përfshihen të ardhurat e realizuara nga shitja e kuotës që një ortak zotëron në një biznes apo ortakëri, apo të ardhurat e realizuara nga shitja e aksioneve. Ndryshe nga grupet e tjera, baza tatimore në këtë rast është diferenca midis:

1. Të ardhurave nga shitja apo likuidimi i biznesit me vlerën e kontributit në para ose natyrë të ortakëve;

a) të ardhurave nga shitja e kuotës së pjesemarrjes në kapital me vlerën nominale ose të blerjes së kuotes;

b) të ardhurave nga shitja e aksioneve me vlerën nominale ose të blerjes aksioneve;

c) totali i kuotës së pjesëmarrjes ose pjesës së kapitalit të tërhequr nga një ortak ose pronar me kapitalin fillestar të kontribuar prej tij në kapitalin themeltar.

2.3.9 Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g).

Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jo rezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh. individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta, etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaron ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit.

Edhe në rastet kur paguesi i të ardhurës është person juridik apo fizik i regjistruar në organet tatimore shqiptare ose çdo ent, organizatë joqeveritare, apo organ i qeverisjes qendrore apo vendore në Shqipëri, apo përfaqësi e organizmave ndërkombëtare apo ambasadë e huaj në Shqipëri, tatimi mbahet në burim në masën *15%* të pagesës dhe derdhet në organin tatimor përkatës brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Në rastet kur përfituesi është individ rezident Shqiptar dhe paguesi është person jo-rezident (i pa regjistruar në organet tatimore Shqiptare), përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë tatimin në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Deklarimi i të ardhurës dhe i shumës së tatimit bëhet sipas modelit të formularit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi.

2.3.10 Në germën "h", të nenit 8 "Të ardhura të tatueshme" të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, në të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, përfshihen të ardhurat e individëve, në formë monetare që shkojnë për shtimin e kapitalit të shoqërisë, të përfituara nga jashtë shoqërisë. Nëse këto të ardhura të individëve nuk janë tatuar më parë, ndërkohë që kanë qenë e janë objekt i tatimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale, për këto të ardhura paguhet tatimi në masën 15%. Lidhur me origjinën e krijimit të të ardhurave në formë monetare, që shkojnë për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga individi investues, duhet të paraqitet në organin tatimor një deklarim lidhur me origjinën e të ardhurave personale. Ky deklarim duhet të paraqitet sipas formularit 1 "Deklarimi i individit kontribues në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij, jo më vonë se data e derdhjes së të ardhurave për shtimin e kapitalit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Për individët e huaj ky deklarim duhet të paraqitet sipas formularit 2 "Deklarimi i individit kontribues të huaj në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij. Bazuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë kanë të drejtë të emërojnë me prokurë, një person, i cili e përfaqëson atë në raport me administratën tatimore, në rastet e pamundësisë për

t'u paraqitur për kryerjen e veprimeve të mësipërme.

Në këtë deklarim duhet përshkruar burimi i këtyre të ardhurave. Bashkëngjitur me këtë deklarim, duhet të vendoset dokumentacioni plotësues zyrtar që vërteton shumën e këtyre të ardhurave dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale, përpara se këto të ardhura të investohen për shtimin e kapitalit të shoqërisë. Nëse ky dokumentacion mungon ose nuk vërteton, që për vlerën e plotë të të ardhurave të kontribuara është paguar tatimi mbi të ardhurat personale, mbi këtë vlerë të të ardhurave duhet të paguhet tatimi mbi të ardhurat në masën 15%. Ky tatim do të paguhet në të njëjtën datë që individi do të deklarojë të ardhurën monetare për shtimin e kapitalit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Pagesa e tatimit mbi të ardhurën për kontributin në kapitalin e shoqërisë duhet të derdhet nga individi kontribues, në llogarinë bankare të Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku shoqëria është e regjistruar, me përshkrimin në dokumentin bankar të pagesës:

Derdhur tatim mbi të ardhurat për shtimin e kapitalit të shoqërisë _____.

Shembull

Të ardhurat në formën monetare që do të shkojnë për shtimin e kapitalit të shoqërisë, në shumën 10,000,000 lekë janë përfituar nga shitja e një pasurie të patundshme, si dhe nga kursime personale të një individi. Individi duhet të deklarojë origjinën e të ardhurave personale të kësaj shume e cila do të shkojë për shtimin e kapitalit të shoqërisë "X", si më poshtë:

a) nga shitja e pasurisë së patundshme (shitja e një apartamenti) në shumën 5,000,000 lekë;

b) të ardhura nga punësimi në shumën 2,000,000 lekë për "Z" vite, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të ardhura të tjera të padokumentuara për shumën 3,000,000 lekë.

Në lidhje me këto të ardhura të cilat shkojnë për rritjen e kapitalit individi tatimpagues duhet të shoqërojë deklaratën me dokumentacionin si më poshtë:

a) vërtetim nga hipoteka për shitjen e apartamentit dhe vlerën e përfituar të shitjes (pa tatimin e mbajtur);

b) fotokopje të noterizuar të librezës së punës për vitet që individi ka punuar dhe ka përfituar këto të ardhura;

c) dokumente të tjera vërtetuese për justifikimin e origjinës së të ardhurave:

Nëse për vlerën 3,000,000 lekë nuk disponohet dokumentacion lidhur me origjinën dhe nuk ka dokumentacion që vërteton pagesën e tatimit mbi këto të ardhura, duhet të bëhet pagesa e tatimit mbi të ardhurat në masën 15%, mbi shumën 3,000,000 lekë, e barabartë me 300,000 lekë.

Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore nga individi së bashku me dokumentin e pagesës së tatimit.

Drejtoria rajonale tatimore, me marrjen e dokumentacionit të mësipërm dhe një kopje të mandatpagesës së tatimit, pajis individin me vërtetim sipas formularit 3 "Vërtetim i drejtorisë rajonale tatimore mbi të dhënat e deklaruara nga individi kontribues në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij, ku konfirmohen të dhënat e deklarimit.

Këtë vërtetim së bashku me kopjet e dokumentacionit të paraqitur në drejtorinë rajonale tatimore, individi ia dorëzon shoqërisë e cila ia bashkëlidh kërkesës për aplikim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për zmadhim e kapitalit. Mungesa e tij e bën aplikimin të pavlefshëm dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit nuk procedon për regjistrimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë.

Procedura e mësipërme për rritjen e kapitalit zbatohet për të ardhurat me burim brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2.4 Në zbatim të nenit 8/1 "Të ardhura të përjashtuara", përjashtohen nga detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale:

1. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për familjet dhe individët pa të ardhura apo me të ardhura të ulëta sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës;

2. Bursat e nxënësve dhe studentëve, pavarësisht nga burimi i financimit, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale, deri në masën e përcaktuar në dispozitat e legjislacionit dhe dispozitave nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë që sanksionojnë bursat e nxënësve dhe studentëve;

3. Shpërblimet e marra për rastet e sëmundjeve apo fatkeqësive, në përputhje me dispozitat e legjislacionit dhe dispozitave nënligjore në fuqi. Këtu përfshihen shpërblimet e dhëna nga punëdhënësi të punësuarve për raste sëmundjesh apo fatkeqësish, por masa e shpërblimit që përjashtohet nga tatimi nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave vjetore nga punësimi të punonjësit përfitues të shpërblimit;

4. Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare apo në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike. Në çdo rast përjashtimi duhet të bazohet në dokumentacionin ligjor që vërteton natyrën e këtyre të ardhurave;

5. Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Në çdo rast, përjashtimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë depozituar dokumentacioni ligjor (dispozitat e marrëveshjes) që japin përjashtimin, si dhe të jenë respektuar procedurat e vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për këtë qëllim;

6. Të ardhurat e përfituara, si rezultat i kompensimit financiar, për ish-pronarët dhe ish-të dënuarit politikë;

7. Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve;

8. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore;

Përfitimet për punonjësit e larguar nga puna për të cilët Gjykata ka vendosur kthimin në vendet e punës dhe përfitimin e pagës deri në momentin e kthimit në punë, nuk janë objekt përjashtimi;

9. Të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë, të dhëna nga institucionet buxhetore, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, që përcaktojnë masën dhe kriteret e përfitimit, të përcaktuara, gjithashtu, në ligjin vjetor përkatës "Për buxhetin e shtetit";

10. Të ardhurat që një fermer i regjistruar përfiton nga shitja e tokës bujqësore te një fermer apo person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor.[1]

11. Pagesat e kontributeve që bëhen nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe pagesat e kontributeve të bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar.

Pagesa e bërë nga vetë anëtari në fondin e pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin "Për fondet e pensioneve vullnetare", e parashikuar në kontratën që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit, është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo pagesë i zbritet së ardhurës personale të tatueshme përpara përllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga agjenti i mbajtjes së tatimit. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

Në rastet kur punëdhënësi ka krijuar një fond pensioni për punëmarrësin, kontributet e paguara prej punëdhënësit në fondin e pensionit për llogari të punëmarrësit nuk janë pjesë e së ardhurës së tatueshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

Në rastet kur një kontribues tjetër i ndryshëm nga vetë anëtari ose punëdhënësi derdh një kontribut në emër të anëtarit të fondit, ky kontribut është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale nga paga. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

12. Të ardhurat që rezultojnë nga kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve, gjatë administrimit nga shoqëria administruese.

2.5 TARIFAT TATIMORE

2.5.1 Në zbatim të nenit 9, pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës do të tatohen sipas tarifave të pasqyrës nr.1 "Tabela e Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

2.5.2 Dividentët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, tatohen me 8 për qind. Interesat nga huat, depozitat ose kontratat e ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, qiratë apo të ardhura nga kontrata e tjera të ngjashme (huapërdorja, enfiteoza), tatohen 15 për qind në përputhje edhe me sqarimet e dhëna në dispozitat e tjera të këtij udhëzimi (pikat 2.3 dhe 5).

2.6 MBLEDHJA E TATIMIT

2.6.1 Në zbatim të nenit 10, çdo punëdhënës që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në germën "a" të nenit 8 të ligjit është i detyruar të llogarisë dhe të mbajë në burim tatimin mbi të ardhurat personale (të ardhurat nga punësimi), në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të ligjit. Tatimi i mbajtur nga punëdhënësi duhet të derdhet në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Deklarimi dhe pagesa e këtij tatimi do të bëhet duke përdorur deklaratën "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", që i bashkëngjitet udhëzimit të ministrit të Financave për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

---

[1] Në pikën 2.4 "Të ardhura të përjashtuara", në nënpikën 10 pas fjalisë "Të ardhurat e përfituara nga kalimi i së drejtës së pronësisë….", shtohet fjalia me udhëzimin nr. 4, date 21.2.2019 me këtë përmbajtje:
"Përjashtohen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar."

Kjo deklaratë, e cila është njëkohësisht edhe deklaratë për efekte të detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dorëzohet në administratën tatimore sipas mënyrës së parashikuar në ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, pa përfshirë këtu kategoritë "Të vetëpunësuar të vetëm dhe të vetëpunësuar me pjesëtarë të papaguar të familjes", në rolin e punëdhënësit duhet të llogaritin dhe të mbajnë tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për punëmarrësit e tyre për çdo muaj. Dorëzimi i formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe pagesa e tatimit për llogari të administratës tatimore bëhet në baza tremujore, jo më vonë se data 20 të muajit që pason mbylljen e çdo tremujori.

2.6.2 Punëdhënësit detyrohen të bëjnë ndalesat në borderotë e pagave (listpagesat), për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me punësimin aktual (të ardhurat nga punësimi). Të ardhurat nga punësimi për çdo punonjës dhe llogaritja dhe mbajtja e tatimit pasqyrohen në formularët përkatës që i bashkangjiten këtij Udhëzimi dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave ne zbatim te ligjit Nr. 9136, Datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetesore", i ndryshuar . Këto të dhëna mujore do të hidhen në librin përmbledhës ku janë pasqyruar të gjithë të punësuarit dhe ndalesat përkatëse sipas muajve. Në fund të fletës të muajit përkatës të regjistrit, regjistrohet edhe numri dhe data e urdhër-xhirimit që pasqyron derdhjen në llogarinë e administratës tatimore të detyrimit përkatës.

2.6.3 Për pagesa të tjera që lidhen me të ardhurat e listuara në gërmat b deri g të Nenit 8, paguesi i të ardhurave mban në burim tatimin, sipas tarifave të përmendura në pikën 2.5.2. më lart, dhe e derdh atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

2.6.4 Për të ardhura të realizuara nga burime jashtë Shqipërisë dhe/ose të paguara nga persona të cilët nuk mund të bëjnë mbajtjen e tatimit në burim për llogari të organeve tatimore Shqiptare, përfituesi i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor përkatës tatimin në masën *15 për qind* të të ardhurave të realizuara jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

2.7 KALIMI I SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PASURITË E PALUAJTSHME

2.7.1 Me kalim të së drejtës së pronësisë (ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore), kuptohet akti i shitjes, dhurimit apo heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme. Me termin "fitim kapital i realizuar", kuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme tokë dhe/ose ndërtesë. Në rastin e dhurimit apo heqjes dorë, për efekt të llogaritjes së tatimit, vlera e pasurisë së paluajtshme që dhurohet përcaktohet në bazë të udhëzimit të përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme". Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme.

2.7.2 Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme tatohet siç përcaktohet në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme.

2.7.3 Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Derdhja bëhet para kryerjes së regjistrimit të sendeve të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme mbledhin tatimin lidhur me kalimin e së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe e deklarojnë atë sipas formularit të deklarimit dhe të pagesës së tatimit të mbajtur në burim, jo më vonë se data 20 e muajit që pason. Brenda datës 20 të muajit pasardhës, zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, dërgojnë në degën përkatëse të tatimeve evidencën përkatëse, e cila përmbledh emrin e personit tatimpagues, shumën e llogaritur të tatimit, si dhe numrin dhe datën e dokumentit të derdhjes së këtij detyrimi në organin tatimor.

2.8. DEKLARATA INDIVIDUALE VJETORE E TË ARDHURAVE

2.8.1 Detyrimi për dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave e kanë të gjithë individët rezidentë në Republikën e Shqipërisë për të ardhurat vjetore totale bruto të realizuara brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Detyrimin për deklarim e kanë edhe individët jorezidentë vetëm për të ardhurat e tatueshme të realizuara prej tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë kur këto të ardhura bruto janë në shumën 2,000,000 lekë dhe mbi këtë shumë. Deklarata individuale vjetore e të ardhurave dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore më të afërt me vendbanimin e individit.

2.8.1.1 Dorëzimi i deklaratës individuale vjetore bëhet jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore për të cilën bëhet deklarimi. Përjashtimisht, nga ky afat vetëm për vitin tatimor 2011, deklarata dorëzohet deri në datën 30 shtator 2012.

2.8.1.2 Deklarata individuale vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal të letërnjoftimit të individit, i cili shërben si kod fiskal. Numri i identifikimit personal i letërnjoftimit shërben si kod fiskal

edhe për individët jorezidentë.

2.8.1.3 Nëse individët rezidentë realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet brenda dhe jashtë Shqipërisë në shumën më pak se 2 milionë lekë, nuk kanë detyrim për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. Nëse individët jorezidentë realizojnë të ardhura bruto vjetore me burim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në shumën më pak se 2 milionë lekë, nuk kanë detyrim për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave.

2.8.1.4 Deklarata e të ardhurave individuale vjetore mund të plotësohet edhe nga individët të cilët nuk kanë detyrimin ligjor për të plotësuar dhe dorëzuar deklaratën, nëse këta individë duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme e parashikuar në ligj, kur plotësojnë kushtet e përfitimit të zbritjes së shpenzimeve.

2.8.2 TË DHËNAT QË DUHET TË PËRMBAJË DEKLARATA VJETORE E TË ARDHURAVE

2.8.2.1 Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga individi që mbart detyrimin për të deklaruar. Bashkëngjitur këtij udhëzimi, si pjesë përbërëse e tij janë "Deklarata individuale vjetore e të ardhurave të individëve shqiptarë"(formulari/D1), rezidentë dhe jorezidentë"Deklarata individuale vjetore e të ardhurave, të individëve të huaj" (formulari/D1), rezidentë dhe jorezidentë dhe formulari i pagesës së tatimit mbi të ardhurat individuale vjetore, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 13/7 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Deklaratat shoqërohen me udhëzuesit për plotësimin e çdo rubrike të saj nga individi deklarues.

2.8.2.2 Në rast të plotësimit të gabuar të deklaratës, individi mund të korrigjojë deklaratën, duke plotësuar një deklaratë të re, duke vendosur shenjën "X" në kutinë përkatëse (deklaratë korrigjuese), brenda tre muajve nga data e dorëzimit të deklaratës së parë. Individi tatimpagues deklarues ka të drejtën e korrigjimit për saktësim të deklaratës së dorëzuar prej tij deri në dy herë pa u penalizuar, brenda tre muajve nga dorëzimi i deklaratës. Në rast të një korrigjimi tjetër të tij, pas atij të dytë, brenda afatit tremujor nga dorëzimi i deklaratës fillestare ndaj individit tatimpagues deklarues zbatohen sanksionet e përcaktuara në nenin 115 "Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim" të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2.8.2.3 Mund të bëjnë deklarim edhe individët tatimpagues, të cilët nuk janë subjekt i deklarimit, sipas pikës 4 të nenit 13 të ligjit, por duan të plotësojnë deklaratën në bazë të pikës 5 të nenit 13 dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë.

Në rastin e bashkëshortëve, me të ardhura totale vjetore bruto të secilit prej tyre deri në shumën 1,050,000 lekësh, për përfitimin e shpenzimeve të zbritshme, deklarata mund të plotësohet vetëm nga kryefamiljari.

Në rastin e bashkëshortëve me të ardhura vjetore bruto të kryefamiljarit që e tejkalojnë limitin prej 1,050,000 lekë, dhe të ardhura vjetore bruto të bashkëshortes deri në shumën 1,050,000 lekë, deklarata për përfitim nga shpenzimet e zbritshme mund të plotësohet vetëm nga bashkëshortja.

Në rast se të ardhurat vjetore bruto të kryefamiljarit tejkalojnë shumën prej 2,000,000 lekësh dhe në bazë të ligjit kryefamiljari ka detyrim për plotësimin e deklaratës vjetore të të ardhurave personale, por jo të përfitojë nga shpenzimet e zbritshme dhe bashkëshortja e tij ka totalin e të ardhurave vjetore bruto më të vogla se 1,050,000 lekë, atëherë kjo e fundit nuk mund të përfitojë nga e drejta e plotësimit të deklaratës për efekt të shpenzimeve të zbritshme.

2.8.3 TË DHËNAT PËR TË ARDHURAT BRUTO

Të dhënat në lidhje me të ardhurat bruto janë të përcaktuara në nenin 13/2 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Këto të dhëna, si për individët shqiptarë edhe për individët e huaj, janë pasqyruar të detajuara në deklaratat individuale vjetore të të ardhurave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.8.4 SHPENZIME TË ZBRITSHME

2.8.4.1 Tatimpaguesit, të cilët nuk janë subjekt i deklarimit, sipas pikës 4 të nenit 13 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, por duan të plotësojnë deklaratën në bazë të pikës 5 të nenit 13 të këtij ligji dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave), por jo më të lartë se kjo shumë, mund të jenë subjekte deklaruese. Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së tatueshme të këtyre individëve që plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave, sipas pikës 5 të nenit 13 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, janë shpenzime të zbritshme, shpenzimet e mëposhtme:

a) shfuqizuar;

b) shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari;

c) shpenzimet për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, sipas përcaktimeve të rregulluara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ç) shfuqizuar.

Shuma e shpenzimeve të zbritshme nuk duhet të jetë më e madhe sesa shuma e të ardhurave bruto të tatueshme

vjetore.

Në rast të plotësimit të deklaratës nga individi (jokryefamiljar), shpenzimet vjetore për mjekim, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor janë 8,532 lekë, vetëm për individin deklarues.

Në rast të plotësimit të deklaratës nga kryefamiljari, bazuar në pikën 3 të nenit 13/1 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, shpenzimet vjetore për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor janë 8,532 lekë për secilin anëtar të familjes, por jo më shumë se 32,000 lekë, shuma këto të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rasti kur deklarata vjetore individuale e të ardhurave plotësohet prej kryefamiljarit, duke përfshirë në të edhe personat nën kujdestari të cilët nuk krijojnë të ardhura, ilustrohet nëpërmjet shembullit të mëposhtëm:

Shembull. Në një familje të përbërë nga kryefamiljari, bashkëshortja dhe 3 fëmijët, kryefamiljari ka realizuar të ardhura individuale vjetore gjithsej në shumën 700,000 lekë, bashkëshortja ka realizuar të ardhura individuale vjetore gjithsej në shumën 600,000 lekë, ndërsa fëmijët nuk kanë të ardhura individuale. Gjatë vitit 2011 kryefamiljari ka marrë kredi në bankë për shkollim për fëmijët. Interesat e kredisë për shkollim gjatë vitit 2011 janë në shumën 100,000 lekë.

Në zbatim të nenit 13 të ligjit, asnjë nga, as kryefamiljari e as bashkëshortja nuk kanë detyrim për plotësimin e deklaratës vjetore të të ardhurave individuale, sepse asnjëri prej tyre nuk përmbush kriterin e të ardhurave vjetore bruto mbi shumën prej 2,000,000 lekësh.

Në bazë të nenit 13.3 të ligjit, sipas shpjegimit të dhënë në këtë udhëzim, kryefamiljari mund të plotësojë deklaratën për përfitim nga shpenzimet e zbritshme. Meqenëse kryefamiljari për periudhën tatimore ka realizuar të ardhura individuale vjetore gjithsej 700,000 lekë (pra më pak se kufiri 1,050,000 lekë), ka të drejtën të përfitojë nga njohja e shpenzimeve të zbritshme të përcaktuara në nenin 13/3 të ligjit dhe në rastin konkret përfiton nga njohja e shpenzimeve të zbritshme për interesat e kredisë në shumën 100,000 lekë. Në çdo rast shuma e shpenzimeve të zbritshme nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e të ardhurave të tatueshme.

Për fëmijët, meqenëse nuk kanë realizuar të ardhura (sipas shembullit), ata duhet të deklarohen në deklaratën e kryefamiljarit, duke plotësuar rubrikën përkatëse "Persona në kujdestari të deklaruesit", të seksionit A të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave me të njëjtin numër 3 (tre), sipas modelit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.8.4.2 Personat jorezidentë nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në pikën 1 të nenit 13/3 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

2.8.5 SHKALLA TATIMORE

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të individit tatimpagues është 15 për qind.

2.8.6 MBAJTJA E DOKUMENTACIONIT

2.8.6.1 Për çdo të ardhur të deklaruar në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave, individi tatimpagues në rast të një kërkese nga organit tatimor, duhet t'i paraqesë të këtij të fundit, dokumentacionin, si më poshtë:

a) për të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit, vërtetim nga punëdhënësi mbi të ardhurat vjetore dhe tatimet e mbajtura mbi pagën;

b) shfuqizuar;

c) për të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit, kopje të vendimit të asamblesë së ortakëve apo aksionarëve për miratimin e rezultatit financiar dhe destinimin e fitimit, ku specifikohet dividendi i shpërndarë dhe kopje të mandatpagesës së bërë të tatimit mbi dividendin nga personi juridik;

d) për të ardhurat bruto nga qiraja kopje të kontratës së qirasë dhe të dokumentit që vërteton pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja;

dh) për të ardhurat bruto dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit, një kopje të kontratës dhe të dokumentit që vërteton pagesën e tatimit mbi fitimin kapital nga shitja e pasurisë së paluajtshme;

e) për të ardhurat bruto nga interesat bankarë, dokumentin bankar që vërteton këto të ardhura;

f) për fitimin kapital neto, të krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme, kopje të kontratës së investimit dhe mandatpagesës së tatimit;

g) për shumat bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit, kopje të vërtetimit të organizatorit të lojërave të fatit apo lotarisë, për fitimin e shumës së fituar të parave dhe kopje të mandatpagesës nga organizatori të tatimit në burim, si diferencë midis shumës së fituar dhe shumës së luajtur nga lojtari;

h) për të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike, kopje të licencave/lejeve dhe mandatpagesës së tatimit në burim;

i) për fitimin kapital nga dhurimi, kopje të dokumenteve vërtetuese për justifikimin e origjinës së të ardhurave

dhe mandatpagesës së tatimit të paguar;

j) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, çdo dokument vërtetues për justifikimin e origjinës së të ardhurave dhe tatimit të paguar;

k) për të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, çdo dokument që justifikon realizimin e të ardhurave.

2.8.6.2 Dokumentet që duhet të ruhen nga individi tatimpagues për të provuar shpenzimet e deklaruara prej tij dhe që duhet të paraqiten në çdo kohë kur kërkohet nga organi tatimor janë si më poshtë:

a) për pjesën e shpenzimeve për kontributet vullnetare të pensioneve dhe kontributet vullnetare të individit për jetën dhe shëndetin, të derdhura nga vetë individi, sipas përcaktimeve në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, kopje të kontratës së fondit të pensionit me shoqërinë administruese dhe kopje të pagesave të bëra;

b) për shumat e interesit bankar të kredisë të marra për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, kopje të kontratës me bankën, ku të jetë e specifikuar se kredia e marrë është për shkollim, si dhe kopje të mandatpagesave të interesave bankarë të paguar gjatë vitit;

c) për justifikimin e shpenzimeve të zbritshme për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, kopje të faturave dhe të mandatpagesave të bëra për mjekim në institucionet shëndetësore deri në shumën e përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 9.2.2011.

Në rastin e plotësimit të deklaratës nga kryefamiljari ose bashkëshortja, deklaratës i bashkëlidhet kopja e certifikatës familjare, lëshuar nga zyrat e gjendjes civile në vitin e plotësimit të deklaratës.

2.8.6.3 Dokumentacioni i mësipërm duhet të ruhet nga individi tatimpagues deklarues, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2.8.7 TATIMI PËR T'U PAGUAR

2.8.7.1 Diferenca ndërmjet totalit të të ardhurave bruto me shpenzimet e zdritshme dhe të ardhurat nga punësimi përbën të ardhurën e tatueshme të individit, e cila tatohet me shkallën tatimore prej 15 për qind, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 9 dhe në nenin 11 të ligjit. Mbi këtë bazë përcaktohet shuma e tatimit të llogaritur për të gjitha llojet e të ardhurave të tatueshme, pa përfshirë tatimin e llogaritur për të ardhurat e tatueshme nga punësimi.

Shumës së tatimit, të llogaritur si më sipër i shtohet tatimi i llogaritur mbi të ardhurat nga punësimi (pagën), sipas tarifave progresive dhe në këtë mënyrë përcaktohet totali i tatimit të llogaritur për të gjitha llojet e të ardhurave të tatueshme të individit. Diferenca midis totalit të tatimit të llogaritur për të gjitha llojet e të ardhurave të tatueshme me shumën e tatimeve të paguara gjatë periudhës tatimore, të dokumentuara nga mbajtësi në burim i këtyre tatimeve, përfaqëson shumën e tatimit për t'u paguar nga individi.

Për individët rezidentë tatimpagues shqiptarë, që kanë realizuar të ardhura dhe janë taksuar për to jashtë Republikës së Shqipërisë, tatimet e paguara, të vërtetuara nga autoritetet e këtyre vendeve, janë të kredituesshme në masën e përcaktuar në përputhje me nenin 37 të ligjit.

Plotësimi dhe paraqitja e deklaratës vjetore individuale të të ardhurave në administratën tatimore bëhet jo më vonë se data 30 prill e çdo viti për të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës.

2.8.7.2 Nëse nga plotësimi i deklaratës vjetore rezulton se individi tatimpagues duhet të paguajë tatim, bazuar në rubrikën "Totali për t'u paguar", të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave, individi dorëzon në bankë formularin "Urdhërpagesë e tatimit mbi të ardhurat individuale", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe bën pagesën e tatimit jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës të vitit për të cilin deklarohet.

2.8.7.3 Nëse nga plotësimi i deklaratës individuale vjetore të të ardhurave rezulton diferencë negative, pra nga sa rezulton nga llogaritja sipas deklaratës, individi tatimpagues ka një tepricë të tatimeve si rezultat i llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme, drejtoria rajonale tatimore duhet t'i kthejë me kërkesën e tij shumën e tatimeve të paguara me tepër. Kërkesa e tatimpaguesit për kthim të shumës së paguar tepër duhet të dorëzohet pranë organit tatimor brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave dhe duhet të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit justifikues të të ardhurave dhe shpenzimeve të listuara në pikat 2.8.6.1 dhe 2.8.6.2 të këtij udhëzimi. Individi tatimpagues, kërkesën për kthim të shumës së bashku me dokumentacionin justifikues, e paraqit dorazi pranë organit tatimor, duke u pajisur me një numër protokolli të dorëzimit të tyre. Pasi, drejtoria rajonale tatimore vërteton saktësinë e të dhënave dhe nga verifikimi i tyre apo kontrolli del se informacioni i dhënë në deklaratë është i saktë, drejtoria rajonale tatimore procedon me urdhër rimbursimi të shumës së tatimeve të paguara tepër, në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Me kërkesën me shkrim të deklaruesit, kjo, shuma e paguar tepër mund të përllogaritet edhe si pagesë e kryer për vitin tatimor vijues.

Në rast së gjatë kontrollit rezulton se tatimpaguesi, ka të ardhura të padeklaruara në deklaratë ose dokumente të rreme ose të pasakta, ndaj tatimpaguesit aplikohen penalitetet e përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore.

2.8.8 DORËZIMI I DEKLARATËS

2.8.8.1 Dorëzimi i deklaratës vjetore individuale të të ardhurave bëhet në adresë të drejtorisë rajonale tatimore më të afërt me vendbanimin e tatimpaguesit, dorazi, me postë apo në rrugë elektronike.

Deklaruesit, të cilët zgjedhin dorëzimin e deklarimit dorazi ose në rrugë postare, mund të tërheqin kopje të formularit të deklarimit të të ardhurave individuale vjetore pranë drejtorive rajonale tatimore (zyrat e shërbimit ndaj tatimpaguesve) dhe pasi e plotësojnë e dorëzojnë në drejtorinë rajonale tatimore.

2.8.8.2 Individi i cili ka detyrimin për të plotësuar e dorëzuar deklaratën individuale vjetore të të ardhurave personale, ka të drejtë të emërojë me prokurë, përfaqësuesin e tij ligjor për të plotësuar apo dorëzuar deklaratën e tij. Përfaqësuesi i individit deklarues është një person i përzgjedhur prej tij për ta përfaqësuar në lidhje me çështjet tatimore. Përfaqësuesi i individit merr përsipër të drejta dhe detyrime të individit dhe administrata tatimore është e detyruar të bashkëpunojë dhe operojë me të. Emërimi i një përfaqësuesi nuk e shkarkon individin deklarues nga përgjegjësia tatimore. Ai mbetet ligjërisht përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve tatimore të tij. Fakti që përfaqësuesi i individit mund të bëjë një gabim në deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore, nuk e shkarkon këtë të fundit nga përgjegjësia për gabimin.

2.8.8.3 Në rastin kur individi nuk ka aftësi për të plotësuar deklaratën, kjo e fundit plotësohet nga kryefamiljari ose personi që e ka nën kujdestari dhe nënshkruhet nga të dy.

2.8.9 AFATET E EKZEKUTIMIT TË KREDITIMIT

Kreditimi i shumave të përfituara nga skema e shpenzimeve të zbritshme të parashikuara në nenin 13/3 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat bëhet pas kryerjes së të gjitha procedurave të nevojshme të parashikuara në këtë udhëzim brenda datës 30 shtator të vitit që pason periudhën tatimore për të cilën është hartuar deklarata tatimore individuale vjetore. Përjashtimisht, për deklaratën individuale të vitit 2011, afati i kreditimit është deri në 31 dhjetor 2012.

2.8.10 MOSPLOTËSIMI NË KOHË APO PLOTËSIMI I PASAKTË I DEKLARATËS TATIMORE VJETORE TË TË ARDHURAVE

2.8.10.1 Kur administrata tatimore konstaton raste të mosplotësimit në kohë të deklaratës vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2.8.10.2 Në rastin kur individi tatimpagues, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep informacion të gabuar apo të rremë e të pakorrigjuar nga ai vetë, brenda afatit të parashikuar nga ky ligj për korrigjimin, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit Penal.

2.8.10.3 Për evidentimin e individëve tatimpagues, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat personale që vetëdeklarohen, administrata tatimore hap një regjistër të veçantë, ku regjistron të gjitha të dhënat identifikuese të individëve. Ky regjistër do të përpilohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në formën e një database elektronik, të miratuar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

2.9 Shfuqizuar.

3. TATIMI MBI FITIMIN

3.1 FUSHA E VEPRIMIT TË TATIMIT MBI FITIMIN

- Personat që i nështrohen tatimit mbi fitimit janë:

- Personat juridikë të krijuar sipas Ligjit "Për shoqëritë tregtare" dhe që janë të regjistruar për TVSH-në;

Personat juridike të themeluar sipas Kodit Civil të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurese në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Personat e tjerë juridikë të themeluar ose të njohur si të tillë me Ligje të veçanta;

- Ortakëritë sipas përcaktimit në pikën d të nenit 2 të Ligjit;

- Personat juridike, ortakëritë apo bashkimet e tjera të personave, të themeluara ose të organizuara në bazë të një Ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një selie të përhershme;

- Çdo person tjetër, pavarësisht nga forma juridike e regjistrimit të tij, përfshirë personat fizikë që nuk janë subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, por janë të regjistruar si subjekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

Çdo person jorezident që nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme, të drejtat mbi to, apo nga tjetërsimi i tyre. Ky person jorezident i nënshtrohet tatimit mbi fitimin që rezulton nga shitja e aksioneve objekt i nenit 4 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Pra, jorezidenti nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin nëse ky jorezident është subjekt i tatimit mbi të ardhurat si më sipër. Si rezultat, detyrimi i vetëm për tatimin e jorezidentëve, qoftë për tatimin mbi të ardhurat ose tatimin mbi fitimin, është që burimi i të ardhurave duhet të jetë në Shqipëri, sikurse përcaktohet edhe në nenet 7(2) dhe 17(2) të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Në këtë mënyrë, sigurohet efekt i plotë nga

zgjerimi i konceptit të burimit të të ardhurave në Republikën e Shqipërisë.

3.2 DETYRIMI PËR TË PAGUAR

Në zbatim të nenit 17, tatimpaguesit rezidentë, të cilët i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi fitimin, do të tatohen në Shqipëri për fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shembull:

Një person juridik rezident shqiptar, zhvillon aktivitetin e tij në Tiranë (ku ka zyrat qendrore dhe/ose qendrën efektive të menaxhimit të biznesit të tij) dhe ka njëkohësisht aktivitet (degë, pika shitje – seli të përherëshme) në Durrës si dhe në Milano të Italisë.

Supozojmë se fitimet e realizuara nga ky subjekt për *vitin 2018* kanë qenë:

- Në Tiranë 10.000.000 lek
- Në Durrës 7.000.000 lek
- Në Milano 8.000.000 lek

Totali 25.000.000 lek

Në këtë rast, tatimpaguesi rezident shqiptar në fjalë, paguan tatim mbi fitimin *në masën 15% mbi fitimin* total prej 25.000.000 lekë të realizuar nga të gjitha burimet brenda dhe jashtë vendit. Ky fitim duhet të pasqyrohet në bilancin përmbledhës të zyrave qendrore në Tiranë. Në këtë shembull, nuk eshte konsideruar mundësia e kreditimit te tatimin fitimit të paguar në Itali, problem i cili trajtohet në pikën 7 të këtij Udhëzimi.

Ndërsa tatimpaguesit jorezidentë, paguajnë tatim mbi fitimin vetëm për fitimet me burim në Republikën e Shqipërisë.

Shembull:

Një person juridik rezident italian (i krijuar sipas ligjit Italian), përveç aktivitetit në Itali, ushtron aktivitet edhe në Shqipëri ku vepron si person jorezident në zbatim të legjislacionit shqiptar nëpërmjet një selie të përhershme (që mund të jetë një shesh ndërtimi, një zyrë, zbatimi i një projekti, etj).

Fitimet e realizuara përkatësisht supozojmë se janë:

- Në Itali 40.000.000 lekë

- Në Shqipëri 15.000.000 lekë

Në këtë rast, tatimi mbi fitimin që ky tatimpagues paguan në Shqipëri është 15.000.000 × 15% = 2.250.000 lekë, pasi ai është tatimpagues jorezident dhe paguan tatim mbi fitimin vetëm për fitimet e realizuara në Shqipëri.

3.3 PËRJASHTIMET

Të përjashtuar nga tatimi mbi fitimin janë:

a) Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore.

b) Banka e Shqipërisë.

c) Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përfitime nga organizuesit apo anëtarët e tyre. Në rast se këto subjekte ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të karakterit ekonomik me qëllime fitimi, këto aktivitete janë të tatueshme në bazë të këtij Ligji. Për aktivitetin ekonomik me qëllim fitimi, personat e përmendur në këtë pikë janë të detyruar të deklarojnë në organet tatimore. Në këtë rast, si shpenzime të njohura do të jenë vetëm shpenzimet e kryera për aktivitetin ekonomik fitimprurës dhe si të ardhura do të konsiderohen të ardhurat që i atribuohen këtij aktiviteti ekonomik. Shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, nuk njihen si të zbritshme.

d) Organizatat e punës (sindikatat, konfederatat) dhomat e tregëtisë, industrisë apo bujqësisë si dhe organizmat e ngjashme me to që nuk kanë qëllime fitimi si: urdhëri i mjekut, dhomat e avokatisë, instituti i ekspertëve kontabël, etj; me kusht që pasuria apo fitimi i tyre të mos përdoret për përfitimin e një individi apo të një anëtari të tyre. Po kështu, në rast se subjektet e përmendura në këtë pikë, ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të karakterit ekonomik fitimprurës, ky aktivitet është i tatueshëm në bazë të këtij Ligji.

e) Organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësitë e tyre në Republikën e Shqipërisë (si përfaqësitë apo organizmat e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Europian, etj.), agjensitë e bashkëpunimit teknik dhe përfaqësitë e tyre, që janë të njohura si të tilla nga Shteti Shqiptar me dispozita ligjore dhe përjashtimi nga tatimi i të cilave është parashikuar në marrëveshje të veçanta.

f) Personat e parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i

Shqipërisë.

g) Fondacionet ose institucionet financiare jo bankare të krijuara me Vendim të Këshillit të Ministrave që nuk kanë qëllim fitimi por kanë për qëllim mbështetjen e politikave zhvilluese të Qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive favorizuese për zhvillimin e sektorëve të caktuar si bujqësisë, bizneseve të vogla, etj.

h) Shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të liçensuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

i. Fondi i pensionit vullnetar i administruar nga shoqëritë administruese të fondeve të pensioneve vullnetare.

Fondi i pensionit është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, i përbërë nga kontributet dhe nga investimi i tyre, pasi janë zbritur të gjitha tarifat. Fondi i pensionit zotërohet bashkërisht nga disa persona, në pronësi të ndarë dhe ku pjesët e pronësisë përfaqësohen nga kuota në fondin e pensionit. Administrimi i fondit të pensionit kryhet nga shoqëria administruese në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit dhe synon rritjen e aseteve të këtyre të fundit.

Të gjithë tatimpaguesit e mësipërm, të përjashtuar nga tatimi mbi fitimin, pavarësisht nga përjashtimi, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin vjetor, në të njëjtat afate si tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin.

Për përjashtimet e parashikuara në pikat "c" deri "h" me sipër, Degët e Tatimeve kërkojnë për çdo rast miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

3.4 FITIMI I TATUESHËM

Deklarimi dhe llogaritja e tatimit mbi fitimin bazohet në "Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin", sipas modelit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi.

Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një periudhe tatimore do të shërbejë si bazë bilanci kontabël dhe anekset e tij, të cilat duhet të jenë në përputhje me Ligjin *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", me dispozitat e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe dispozitat e këtij udhëzimi. Në parim, fitimi ose e ardhura neto e tatueshme, del si rezultat i diferencës midis të ardhurave totale (të ardhurat nga aktiviteti normal dhe të ardhura të jashtëzakonshme), përfshirë vlerën e përfitimeve dhe të avantazheve në natyrë, me shpenzimet e kryera me qëllim realizimin dhe ruajtjen e të ardhurave.

3.5 SHPENZIMET E NJOHURA

Shpenzime të njohura janë ato që kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Këto janë të gjitha shpenzimet (përfshirë shpenzimet e jashtëzakonshme) e biznesit, me përjashtim të atyre që janë kryer me qëllim formimin dhe rritjen e kapitalit. Shpenzimet e njohura janë kryesisht shpenzime të destinuara për të ruajtur ekzistencën e kapitalit si burim i të ardhurave dhe për të siguruar në kohën e duhur riformimin apo zëvendësimin e kapitalit (p.sh amortizimi). Shpenzimet e njohura janë shpenzime që njihen si të zbritshme nga të ardhurat për përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qënë të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:

a) të jenë kryer në interes të drejtëpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;

b) të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;

c) të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto;

d) në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor. Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e leshuara nga persona jo-rezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike (p.sh. *Ambasada të huaja, organizma ndërkombëtare, zyra pune, komisariate policie, muzetë e institucioneve publike etj.)* për pagesat e tarifave të shërbimeve që këto ente i kryejnë tatimpaguesve, subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Degët e tatimeve mund të kërkojnë interpretimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me dokumenta të tjera të cilat nuk janë parashikuar në këtë udhëzim por që vërtëtojnë shpenzime biznesore të subjektit.

Materialet dhe mallrat publicitare si postera, spote publicitare ato filmike dhe fotografike, masa e produkteve të të cilave reklamohen në promovimet e promocionet e organizuara, që mbështetur në dokumentacionin justifikues, kryhen për qëllime të biznesit, bazuar në nenin 20 të Ligjit, njihen si

shpenzime të njohura për efekt fiskal. Dokumentacioni që duhet të përdoret për rastet e promocioneve dhe promovimit janë:

- Vendimi i asamblesë së ortakëve ose administratorit ku të jenë të përcaktuar vendi, periudha e organizimit të promocionit, sasia e produkteve që do të shpërndahen, materialet publicitare që do të përdoren, etj.
- Projektideja lidhur me mënyrën e organizimit të promocionit dhe promovimit.
- Procesverbali për produktet që shpërndahen me personat që përfitojnë produktin falas
- Fletëshoqërimi nalli me ekstreme të plotësuara, ku tek marrësi i mallit do të firmosin promovuesit e shoqërisë. Faturat tatimore me TVSH do të jenë ditore për çdo promovues të cilës duhet t'i bashkangjiten në fund të ditës procesverbalet e mbajtura me personat përfitues.

Dokumentacioni që duhet të përdoret për dhënien e dhuratave simbolike :

-Vendimi i asamblesë së ortakëve ose administratorit për llojin dhe sasinë totale të mallrave që dhurohen dhe kujt do t'i dhurohen.

Bursat që u jepen nxënësve dhe studentëve nga institucionet arsimore publike dhe jopublike njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën e përcaktuar me vendime të Këshillit të Ministrave, me kusht që institucionet arsimore publike dhe jopublike, në fillim të vitit shkollor, të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, numrin dhe shumën e bursave që do të përfitohen. Tatimpaguesi paraqet pranë organeve tatimore kopje të dokumentacionit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të numrit dhe shumës së bursave të përfituara nga studentët apo nxënësit. Institucionet arsimore që përfitojnë nga kjo pikë duhet të jenë të akredituara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Konsiderohen, gjithashtu, shpenzime të njohura edhe shpenzimet për kontributet e bëra nga punëdhënësi në interes të punëmarrësve të tij në një plan pensioni profesional, deri në shumën e përcaktuar me ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", për çdo punëmarrës.". Punëdhënësi e krijon planin e pensionit profesional për punëmarrësit e tij, duke lidhur një kontratë me shoqërinë administruese, që do ta ofrojë fondin e pensionit për punëmarrësit e tij. Dokumentacioni ligjor që justifikon shpenzimin e kryer është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

3.6 Shpenzime të panjohura

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, nuk do të njihen si shpenzime të zbritshme, shpenzimet e mëposhtme:

a. Kosto e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe truallit, konsiderohet shpenzim që nuk ka lidhje me rezultatin ushtrimor përkatës, por me investimin në aktivet e biznesit.

b. Kosto e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve, të cilat janë objekt i amortizimit. Për efekte fiskale, në kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të qëndrueshme hyjnë shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe se 15 përqind e vlerës kontabile të mbetur të aktiveve për të katër kategoritë e tyre.

c. Çdo zmadhim i kapitalit të shoqërisë, ose i kontributit në ortakëri, mbi kapitalin ose kontributin fillestar të përcaktuar në kontratën dhe statutin e shoqërisë apo ortakërisë.

d. Vlera e shpërblimeve në natyrë, e cila nënkupton çdo shpërblim të paguar jo në para, por në natyrë dhe që merret si shpërblim, për punën e kryer nga të punësuarit apo persona të tjerë. Të kësaj natyre janë shpërblime të tilla si: kompensimet ushqimore, dhurimi i automjeteve, i paisjeve elektroshtëpiake, bileta për udhëtime turistike, dhënie në përdorim e banesave apo ambjenteve për qëllime personale apo qëllime të tjera që nuk kanë lidhje direkte me biznesin, etj. Vlera e shpërblimeve në natyrë është shpenzim i panjohur për shkak të faktit se ato nuk tatohen si të ardhura personale në zbatim të nenit 8 të Ligjit dhe të pikës 2.3 të këtij Udhëzimi. Në rastet kur shpërblimet e paracaktuara në natyrë jepen në para (psh kompensimi ushqimor për të punësuarit jepet në lekë, pasi subjekti nuk ka mencë për gatim) ato do të konsiderohen si të ardhura personale të individit dhe do të tatohen së bashku me pagën sipas tabelës nr.1 bashkangjitur Ligjit, ndërkohë që do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme të biznesit. Kur shpërblimet në natyrë i jepen personave të tretë (jo të punësuar) ato në asnjë rast nuk do të njihen si shpenzime të lejuara.

e. Kontributet vullnetare për pensione apo sigurime të tjera, (ndërkohë që kontributet e detyrueshme të punëdhënësit sipas ligjit janë shpenzime të zbritshme të biznesit).

f. Dividentët apo ndarjet e fitimit për aksionerët apo ortakët, pasi ato paguhen nga fitimi pasi të jetë paguar tatimi mbi fitimin.

g. Interesat e paguara nga tatimpaguesi gjatë vitit ushtrimor, të cilat tejkalojnë normën mesatare

të interesit 12 mujor të kredisë për tregun bankar sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Po kështu konsiderohet shpenzim i panjohur, shuma e interesave të huasë që kalon raportin 1 me 4, d.m.th. 1 njësi kapitale të veta (kapitali themeltar + diferenca nga rivlerësimet + primet + rezerva të ndryshme + fitime/humbje të mbartura + fitime/humbje të ushtrimit) kundrejt 4 njësi hua, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin 2 të nenit 21 të Ligjit. Huate bankare afatshkurtra me një kohëzgjatje më të vogël se një vit kalendarik nuk konsiderohen për efekt të llogaritjes së raportit të huasë si më sipër. Nga ky kufizim (raporti 1:4) përjashtohen Bankat dhe Shoqëritë e Sigurimit.

h. Gjobat, kamatvonesat dhe kushtet e tjera penale që paguhen nga subjekti për shkelje të ndryshme ligjore apo administrative, janë shpenzime të panjohura për efekt fiskal. Në rastin e faljes së gjobave, kamatvonesave dhe kushteve të tjera penale me akte ligjore e nënligjore (akte administrative) të ardhurat e përfituara nga falja e tyre janë të ardhura të patatueshme ose shpenzime të njohura për efekt fiskal nëse fillimisht në momentin e vendosjes së tyre këto gjoba, kamatvonesa apo kushte të tjera penale janë pasqyruar si shpenzime të panjohura për efekt fiskal.

i. Krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale. Në bazë të ligjit, rezervat krijohen nga fitimi pas tatimit. Këtu përjashtohen rastet kur krijimi i rezervave parashikohet në ligje apo në akte të tjera nënligjore, si në ligjin Nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" i ndryshuar, si dhe në ligjin dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Me rezerva dhe fonde të tjera duhen kuptuar edhe provigjonet për rreziqe (humbje) dhe shpenzime (detyrime) të krijuara nga fitimi pas tatimit sipas përcaktimit në nenin 38 të Ligjit "Për kontabilitetin". Pra për qëllim të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, provigjonet që krijohen për mbulimin e humbjeve ose të shpenzimeve të pritshme, nuk përbëjnë shpenzime të njohura për efekt fiskal.

j. Tatimi mbi të ardhurat personale, akciza, tatimi mbi fitimin dhe TVSH e zbritshme, si më poshtë:

Tatimi mbi të ardhurat personale mbahet 100 përqind nga paga e të punësuarve me detyrimin ligjor për t'u transferuar në llogarinë e organeve tatimore sipas përcaktimeve ligjore. Këtu bëhet fjalë për tatimin mbi të ardhurat personale të llogaritur dhe të mbajtur nga punëdhënësi mbi pagën bruto të punëmarrësve, pagë e cila është përfshirë njëherë në shpenzimet e biznesit. Në këtë mënyrë shmanget mundësia e dublimit të këtyre shpenzimeve në shpenzimet e njohura;

Tatimi mbi fitimin llogaritet mbasi është përcaktuar rezultati financiar (fitim ose humbje). Në këtë kuptim ai nuk është shpenzim por pjesë e rezultatit;

TVSH e zbritshme nuk kontabilizohet në llogarinë e shpenzimeve, ajo redukton TVSH e llogaritur në shitje, duke u kontabilizuar në llogarinë e TVSH-se. Përjashtimisht rastet kur TVSH-ja në blerje nuk kreditohet sipas Ligjit "Për Tvsh" dhe Udhëzimit në zbatim të tij, në këto raste kjo shumë e Tvsh-së do të kontabilizohet në llogarinë e shpenzimeve dhe do të njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt fiskal.

Akciza e paguar në blerje ose në import në çdo rast është shpenzim i zbritshëm. Kështu p.sh. nëse një shoqëri transporti blen karburante, në çmimin e të cilave është përfshirë edhe akciza, e gjithë vlera e këtyre shpenzimeve është shpenzim i njohur. E kundërta ndodh me akcizën e llogaritur në shitje. Kjo akcizë nuk njihet si shpenzim i zbritshëm. Kështu p.sh. një tatimpagues prodhues birre, kur shet birre, llogarit edhe akcizën përkatëse të cilën e mbledh dhe e derdh për llogari të shtetit. Në këtë rast për pjesën e akcizës së llogaritur nuk preken llogaritë e të ardhurave dhe të shpenzimeve. pasi akciza në këtë rast është shtesë mbi çmimin e shitjes (kosto plus fitim) dhe nuk zbritet nga shpenzimet e biznesit;

Tatimi i mbajtur në burim si pjesë e pagesës për shërbime teknike apo shërbime të tjera, nuk rëndon veçmas llogaritë e shpenzimeve, pasi pagesa bruto për shërbimin (përfshirë tatimin në burim) njihet si shpenzim.

k. Shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet për pritje-përcjellje që tejkalojnë vleren e 0,3 % të qarkullimit vjetor (siç është përkufizuar qarkullimi vjetor në Udhëzimin e Ministrisë së Financave "Për TVSH"). Në shpenzimet e përfaqësimit përfshihen shpenzime me karakter të përgjithshëm që një shoqëri bën për prezantimin dinjitoz të saj në marrëdhëniet me partnerët apo institucione të tjera, p.sh. organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, përurimi i linjave apo prodhimeve të reja, qerasjet dhe pritje-përcjelljet që lidhen me marrëdhëniet e biznesit

m. Shpenzimet e konsumit personal, ku përfshihen të gjitha shpenzimet e karakterit të konsumit personal, të cilat nuk kanë lidhje direkte me mbarëvajtjen dhe rezultatin e biznesit. Të tilla shpenzime

konsiderohen për shembull kur tatimpaguesi një pjese të mallrave të prodhuara apo të tregëtuara prej tij i përdor për konsum personal apo familjar, kur një pjesë të karburantit e përdor për automjetin personal apo familjar, shpenzimet telefonike për vete apo persona të tjerë që nuk janë të punësuar në biznes apo funksionet e tyre nuk i justifikojnë këto shpenzime. Gjithashtu, konsiderohen si shpenzime të konsumit personal dhe të panjohura për efekt fiskal edhe shpenzimet për qeratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve vendas dhe të huaj, pavarësisht nga kushtet e vëna në kontratën e punësimit ose shërbimit.

n. Shpenzimet që kalojnë kufijtë e përcaktuar në ligje apo akte nënligjore, siç janë:

- shumat e amortizimit të aktiveve të biznesit, të cilat tejkalojnë normat e përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji;

- shpenzimet që tejkalojnë kufirin e përcaktuar në ligjin "Për sponsorizimet", jo më shumë se 4% të fitimit para tatimit për sponsorizimet në përgjithësi dhe jo më shumë se 10% për sponsorizimet për aktivitete kulturore, sportive,etj., sipas përcaktimit në Ligjin "Për Sponsorizimet", por në asnjë rast totali i sponsorizimeve nuk duhet të kalojë 10% të fitimit para tatimit. Për një tatimpagues i cili rezulton me humbje në vitin korent, shpenzimet e kryera nga ai për sponsorizime gjatë këtij viti, janë shpenzime të panjohura, pra në këtë rast për efekt fiskal, për këtë tatimpagues bëhet korrigjimi i rezultatit;

- Shpenzimet e kryera për dieta të cilat kalojnë kufirin prej 3 mijë lekë për ditë të plota shërbimi brenda vendit dhe 1 mijë lekë për gjysëm ditë shërbimi brenda vendit si dhe shpenzimet e kryera për dieta jashtë vendit të cilat kalojnë kufirin prej 60 EURO për çdo ditë të plotë shërbimi dhe 30 EURO për çdo gjysëm dite shërbimi. Shpenzimet për shërbimet e biznesit brenda ose jashtë vendit duhet të justifikohen me dokumentat përkatëse të udhëtimit, si dokumentat e transportit, faturat e hotelit, pasaporta (vulat e hyrjes e të daljes nga vendi), etj., si dhe dokumentacioni teknik që vërteton nevojat e biznesit të shërbimit brenda ose jashtë vendit; etj.

nj. Shpenzimet për dhurata nuk njihen si shpenzim biznesi, përjashtuar dhuratat simbolike brenda kufirit të shpenzimeve të përfaqësimit të parashikuara në germën "k" të pikës 3.6.

o. Shpenzimet që rrjedhin si rezultat i korrigjimit të regjistrimeve të gabuara kontabile të kryera vitet e kaluara.

Në zbatim të ligjit "Për kontabilitetin", rregjistrimet e gabuara kontabile të viteve të kaluara korrigjohen në vitin që ato konstatohen, por efekti fiskal i tyre do të llogaritet që nga periudha kur janë rregjistruar në mënyrë të gabuar. Në këto raste paguhet detyrimi dhe interesat, por nuk aplikohen gjoba.

p. Çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi.

Kjo do të thotë se asnjë shpenzim për blerje brenda vendit nuk është i njohur nëse ai nuk justifikohet me një nga dokumentat e përshkruara në pikën 3.5, gërma "d").

Fatura që lëshohet nga tatimpaguesit e biznesit të vogël është dokument justifikues për shpenzimet vetëm në rast se ajo përmban të gjithë elementet që përcakton Ligji "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet" (numrin rendor, datën dhe vendin e lëshimit, numrin e Çertifikatës së Ushtrimit të Veprimtarisë, emrin dhe adresën e shitësit dhe blerësit, sasinë, çmimin dhe vleftën e plotë të shitjes, etj.). Kuponat tatimorë të lëshuar nga arkat rregjistruese dhe dëftesat tatimore nuk njihen si dokumente justifikues për shpenzimet.

q. Në bazë të shkronjës "ll", të paragrafit 1, të nenit 21, nuk do të njihet si shpenzim i lejuar vlera e faturave të pranuara për shërbime që janë kryer nga persona të tretë, nëse brenda datës 20 janar të vitit pasardhës nuk është paguar tatimi në burim për ato shërbime, pavarësisht nga fakti nëse është paguar ose jo vlera e faturës. Në rastet kur këto shërbime janë kryer nga persona jorezidentë të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, zbatohen dispozitat e këtyre marrëveshjeve. Kjo do të thotë, se njihet si shpenzim i lejuar, vlera e faturave të pranuara për shërbime të kryera nga persona jorezidentë për të cilat, në zbatim të marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë, nuk është mbajtur tatim në burim.

r. Firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportimit etj., do të njihen si shpenzim i lejuar deri në nivelin e përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas pikës "m" të nenit 21 të ligjit.

s. Në rastin e nxjerrjeve jashtë përdorimit ose shkatërrimit të materialeve apo mallrave të cilat për arsye të ndryshme, si dëmtime, kalim i afatit të skadencës, etj., janë të papërdorshme ose të pa tregtueshme apo tregtohen më çmime të ulura, përfshirë uljen sezonale, shpenzimet përkatëse ose të ardhurat e reduktuara do të njihen për efekt fiskal vetëm nëse vërtetohen me proces-verbalin përkatës të mbajtur nga një komision i posaçëm vlerësimi, dhe subjekti ka njoftuar organin tatimor përkatës. Ky

njoftim duhet te shoqëhet me një kopio të proçes verbalit përkatës. Organi tatimor mund të dërgojë perfaqësuesin e vet që të jetë prezent në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit ose shkatërrimit të mallit, jo më vonë se 5 ditë nga data e njoftimit.

sh. shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50 për qind të fondit të pagës bruto vjetore.

Për hipermarketet ky afat është 24 orë. Proces-verbali i vlerësimit duhet të përmbajë të dhëna të plota mbi sasitë, vlerat, kohën e furnizimit, arsyet e zhvlerësimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i garantuar organeve tatimore mundësinë e verifikimit dhe kontrollit.

Kur secili prej shpenzimeve të përmendura më sipër është regjistruar në kontabilitet dhe është zbritur nga të ardhurat gjatë llogaritjes së fitimit vjetor të tatimpaguesit, ato do të veçohen dhe t'i shtohen fitimit vjetor të tatueshëm.

t. Në rastet e kredive, të huamarrjes ose financimeve nga personat e lidhur, nuk njihen si shpenzime të zbritshme të periudhës tatimore teprica e shpenzimit të interesit neto që tejkalon 30 për qind të fitimit të tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA). EBITDA përcaktohet në përputhje me nenin 19 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".

Me termin "Tepricë të shpenzimit të interesit neto" nënkuptohet teprica që del nga diferenca e shpenzimeve të interesit me të ardhurat nga interesi.

Çdo shpenzim interesi, që nuk zbritet sipas kësaj pike, mbartet në periudhat e ardhshme tatimore, përveç nëse 50 për qind të aksioneve ose të të drejtave të votës në shoqëri janë transferuar.

Përcaktimet e mësipërme nuk zbatohen për bankat, institucionet financiare jobankare të kredidhënies, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.

Shembull:

Të dhënat financiare për shoqëritë A dhe B jepen në tabelën e mëposhtme:

	Shoqëria A (në lekë)	***Shoqëria B (në lekë)***
teprica e shpenzimeve neto të interesit	*+10 milionë*	*+40 milionë*
= EBITDA	*= \100 milionë*	*=100 milionë*
× përqindjen e vendosur	*×30%*	*×30%*
= maksimumi i lejuar si shpenzime të zbritshme	*=30 milionë*	*=30 milionë*
Shpenzimet neto të interesave të pazbritshme	*0*	*10 milionë*

Shoqëria A është pjesë e një grupi shoqërish shumëkombëshe. Shoqëria A ka tepricë të shpenzimeve neto të interesit prej 10 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë lekë. Kjo tepricë e shpenzimeve neto të interesit rezulton nga interesat e kredive/huamarrjeve/financimeve, që shoqëria A ka me palët e lidhura. Për shkak se shoqëria A ka një raport interesi neto / EBITDA nën 30%, ajo mund të zbresë të gjithë shpenzimet neto të interesit.

Shoqëria B është pjesë e një grupi shoqërish shumëkombëshe. Shoqëria B ka tepricë të shpenzimeve neto të interesit prej 40 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë Lekë. Kjo tepricë e shpenzimeve neto të interesit rezulton nga interesat e kredive / huamarrjeve / financimeve, që shoqëria B ka me palët e lidhura. Për shkak se shoqëria B ka një raport interesi neto/ EBITDA mbi 30%, ajo nuk mund të zbresë të gjithë shpenzimet neto të interesit. Shoqëria B në këtë rast lejohet të zbresë 30 milionë lekë shpenzime neto interesi dhe 10 milionë lekë nuk lejohen të zbriten, por mbarten në periudhat e ardhshme tatimore. Kështu, p.sh nëse periudhën e ardhshme tatimore shpenzimet neto rezultojnë 15 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë lekë, shoqëria lejohet të zbresë dhe shpenzimet e mbartura (15+10=25 mil lekë<30 mil lekë, që është vlera e lejuar).

Në rastet e kredive, të huamarrjes ose financimeve nga persona jo të lidhur, zbatohen kufizimet e paragrafit "g" të pikës 3.6.

3.7 AMORTIZIMI

3.7.1 Personat që llogarisin amortizimin

Në zbatim të nenit 22 të ligjit, Amortizimi i aktiveve të biznesit llogaritet nga:

- Pronari i aktiveve;

- Personi që mbart riskun, në rastin e aktiveve të dhëna me qera apo huapërdorje afatgjata ose me qera financiare (leasing), duke u bazuar në të dhënat e kontratave përkatëse, dhe, duke mos lejuar dyfishim të shpenzimeve të amortizimit, tek pronari edhe tek përdoruesi i aktivit.

Në kushtet e zakonshme të qeradhënies, amortizimi do të llogaritet nga pronari i aktiveve dhe përdoruesit i njihet qeraja si shpenzim i lejuar, ndërsa pronari, sigurisht, do të raportojë të ardhurat nga qeraja në të ardhurat e tatueshme.

Aktive të tilla si: toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen.

3.7.2 Normat e amortizimit sipas grupeve

Amortizohen individualisht dhe në mënyrë lineare:

a. Kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, si dhe kostot e konstruksioneve, makinerive e pajisjeve me afat përdorimi më të madh se 20 vjet, të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me ndërtesat ose tokën. Të tilla janë sendet e ngjitura me plumb, gips ose tjetër që nuk mund të shkëputen pa u thyer ose pa u cënuar, ose pa prishur apo dëmtuar pjesën e tokës ose të ndërtesës me të cilën është trupëzuar si p.sh. ashensorët, konstruksionet metalike pjesë e ndërtesës, instalimet elektrike dhe hidraulike, etj. Po në këtë mënyrë amortizohen edhe impiantet e ndryshme të transportimit si: ujësjellësit, naftësjellësit, gazsjellësit, linjat hekurudhore, linjat e tensionit të lartë, teleferikët, e të tjera aktive të ngjashme me to. *Norma e amortizimit të këtyre aktiveve është 5 për qind mbi vlerën e mbetur. Në rastet kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 3% e kostos historike të këtij aktivi, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm në fund të kësaj periudhe tatimore.*

b. Aktivet e patrupëzuara të biznesit si patentat, markat tregtare, shpenzimet e nisjes së aktivitetit, "emri i mirë" në rastet kur ky i fundit është blerë, etj. amortizohen me një normë të lejuar për efekt fiskal prej 15 përqind.

Baza e llogaritjes së amortizimit për dy kategoritë "a" dhe "b" të aktiveve të përmendura më sipër është vlera fillestare e aktivit (kosto historike) të cilës i shtohen edhe kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktivit. Për llogaritjen e amortizimit merret për bazë koha (muaji) e hyrjes apo e daljes së aktivit, sipas përcaktimit të bërë në Planin Kontabël.

Amortizohen mbi bazë grupimi:

c.Kompjuterat, sistemet e informacionit, programet kompjuterike dhe në përgjithësi produktet software e pajisjet e ruajtjes së të dhënave. Norma e amortizimit për këtë kategori aktivesh është 25 përqind.

d. Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë të cilat nuk përfshihen në grupimet "a", "b" dhe "c" të përmendura më sipër, si makineritë e pajisjet e prodhimit e të shërbimit, mjetet e transportit të të gjitha llojeve, etj., amortizohen me një normë të lejuar për efekt fiskal prej 20%.

Baza e llogaritjes së amortizimit për dy kategoritë "c" dhe "d" të aktiveve të përmendura

më sipër është vlera kontabël e mbetur e grupit të aktiveve (vlera fillestare minus amortizimi), të cilës i shtohen edhe kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të grupit si dhe i zbriten të ardhurat nga shitja dhe kompensimet e marra.

Normat e lejuara për efekt fiskal në masën 5%, 15%, 20% dhe 25% janë të alpikueshme dhe për llogaritjen e amortizimit te aktiveve të dhëna me qera financiare (leasing), nga personi që mbart riskun, pamvarësisht nga kohëzgjatja e kontratës së qerasë financiare.

Për të gjitha aktivet që hyjnë gjatë periudhës ushtrimore, llogaritja e amortizimit fillon nga dita e parë e muajit që pason muajin e hyrjes, duke ndjekur të njëjtin rregull edhe për muajin e daljes së aktivit, pra amortizimi pushon së llogarituri ditën e parë të muajit që pason muajin e daljes. *Llogaritja e amortizimit ndërpritet për të gjitha llojet e aktiveve afatgjata që nuk marrin pjesë në veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit, përfshirë mospërdorimin e tyre apo daljen jashtë veprimtarisë.*

Për të katër kategoritë e aktiveve të përmendura më sipër, për efekte fiskale, konsiderohen kosto të përmirësimit, të rinovimit dhe të rikonstruksionit, shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe së 15 përqind e vlerës kontabël të mbetur të aktiveve. Kur këto shpenzime janë më të vogla së 15 përqind e vlerës kontabël të mbetur të aktivit përkatës, ato konsiderohen shpenzime për mirëmbajtjen e aktivit dhe pasqyrohen totalisht si shpenzime biznesi për periudhën korente.

Persa i takon shpenzimeve të mirëmbajtjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit në një transaksion qiraje financiare, nëse qiramarrësi mbart riskun për humbjen apo shkatërrimin e aktivit, përballon këto shpenzime sigurisht të justifikuara me dokumentacionin e nevojshëm, në perputhje me përcaktimet e bëra në paragrafin e mësipërm.

Po kështu do të njihen si të zbritëshme në varësi të përcaktimit të pronësisë së aktivit të dhënë me qera financiare edhe shpenzimet për tarifat e tjera që paguhen, pranë organeve shtetërore siç janë taksa e regjistrimit të përvitshëm për automjetet, primet e sigurimit etj.

e) Për kategoritë e aktiveve të përmendura në germat "c" dhe "d", në rastet kur vlera e mbetur e aktivit në fillim të periudhës tatimore është më e vogël se 10% e kostos historike të këtij aktivi, atëherë kjo vlerë e mbetur do të njihet tërësisht si shpenzim i zbritshëm në fund të kësaj periudhe tatimore.

3.8 INVENTARI

Për vlerësimin e gjendjes së inventarit në fund të periudhës tatimore, tatimpaguesi mund të përdorë një nga metodat e vlerësimit të parashikuara në ligjin për Kontabilitetin, duke mos e ndryshuar këtë metodë nga njëra periudhë në tjetrën pa patur arsye të forta objektive për një ndryshim të tillë. Ndryshimi i metodës së vlerësimit mund të bëhet vetem pasi të jetë njoftuar me shkrim Dega përkatëse e Tatimeve jo më vonë se 30 ditë para fillimit të periudhës tatimore në të cilën do të aplikohet metoda e re e vlerësimit.

3.9 BORXHET E KËQIJA

Me borxh të keq kuptohet një kërkesë për t'u arkëtuar (detyrim debitor) e cila për shkak të gjendjes së keqe financiare të debitorit, vënies së tij në faliment ose për një shkak tjetër që nuk varet nga kreditori, kthehet në një detyrim që mund të mos arkëtohet tërësisht ose pjesërisht.

Një borxh i keq, që të njihet si i tillë gjatë vitit ushtrimor, duhet të përmbushë njëkohësisht tre kushtet e mëposhtme:

- Shuma e këtij borxhi të jetë përfshirë më përpara në të ardhurat e tatimpaguesit (me faturë ose dokumentacion tjetër qe është kontabilizuar si e ardhur në evidencën kontabile).

- Për arkëtimin e tij janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme ligjore dhe janë zbatuar sanksionet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe pasi nuk është bërë i mundur arkëtimi, ai dokumentohet me vendim të gjykatës apo organeve të tjera kompetente të njohura me ligj.

- Kur ky borxh është fshirë nga librat kontabël, gjë që do të thotë se është kaluar nga llogaritë përkatëse të klientit ku është kontabilizuar fillimisht, në llogaritë e rezultatit financiar të subjektit.

Nëse për çdo rast, një shumë e njohur më parë si borxh i keq arkëtohet gjatë vitit korent, kjo shumë përfshihet në të ardhurat e këtij viti.

Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së kredidhënies, në kuptim të nenit 24 shkronja "c" të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", borxhi i keq mund të fshihet nga librat kontabël:

i) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm te përmbaruesi gjyqësor, në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme; ose

ii) 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme/të paluajtshme.

iii) në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë, ekzekutohet para afateve të përcaktuara në shkronjën i) më lart, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të vazhdojnë të njihen si të tilla.

3.10 PJESËMARRJET QË PËRJASHTOHEN NGA TATIMI MBI FITIMIN

Dividendët dhe ndarjet e fitimit të përfituara respektivisht nga shoqëri dhe ortakëri rezidente shqiptare (përfituesit), me qëllim që të shmanget tatimi i dyfishtë, përjashtohen nga tatimi mbi fitimin, me kusht që këta dividendë të jenë paguar nga një shoqëri rezidente tatimore shqiptare ose një shoqëri jorezidente apo fitimi të jetë ndarë nga një ortakëri rezidente tatimore shqiptare ose një ortakëri jorezidente.

Dividendët ose shpërndarjet e fitimit të përfituara nga një shoqëri ose ortakëri (shkurt përfituesi) përjashtohen nga tatimi mbi fitimin, kur plotësohen të dy kushtet që vijojnë:

- Përfituesi është rezident tatimor shqiptar në kuptimin e paragrafit 3 të nenit 3 të ligjit.

- Paguesi (shoqëria ose ortakëria që bën shpërndarjen e dividentëve apo ndarjen e fitimit) është rezidente tatimore shqiptare në kuptimin e paragrafit 3 të nenit 3 (pra, dividentët ose ndarjet e fitimit janë bërë pasi është paguar tatimi mbi fitimin), ose jorezident tatimor shqiptar.

3.11 MBARTJA E HUMBJEVE

Humbja e rezultuar dhe e njohur nga organet tatimore, mund të mbartet në tre vitet e ardhshme rradhazi. Per shembull, nëse një subjekt ka rezultuar në vitin 2000 me 9 milionë lekë humbje, ai ka të drejtë ta mbartë këtë humbje në tre vite radhazi deri në vitin 2003. Kështu, nëse subjekti në fjalë rezulton me një fitim prej 4 milionë lekë në vitin 2001, për efekt fiskal, i lejohet të përdorë të gjithë fitimin e këtij viti për të mbuluar humbjen e vitit parardhes. Pra, nga 9 milionë humbja reduktohet në 5 milionë lekë. Nëse në vitin 2002 subjekti rezulton përsëri me një humbje, prej, p.sh., 3 milionë lekë, ai ka të drejtë ta mbartë atë në tre vitet e ardhshme, pra deri në vitin 2005. Nëse në vitin 2003 subjekti rezulton me fitim 2 milionë lekë, ai mund ta përdorë këtë fitim për të mbuluar humbjen e mbetur prej 5 milionë nga humbja e vitit 2000, e cila tashmë reduktohet në 5-2 = 3 milionë lekë. Nëse në vitin 2004 subjekti do të rezultojë p.sh. me 6 milionë lekë fitim, ai ka të drejtë të mbulojë me këtë fitim humbjen e rezultuar në vitin 2002 pra 3 milionë, dhe fitimi i mbetur prej 3 milionë tatohet normalisht. Në këtë mënyrë, e drejta e mbartjes së humbjes së mbetur nga viti 2000 ka përfunduar (për efekt fiskal nuk njihet mbulimi i saj me fitimin e vitit 2004). Kështu, çdo humbje mund të mbartet deri në tre vitet e ardhshme, duke u evidentuar veçmas humbja e çdo viti, me parimin sipas të cilit humbja më e hershme mbartet përpara humbjes më të vonë. Nëse një humbje nuk arrin të mbartet për tre vite pasardhëse radhazi (pasi subjekti mund të rezultojë përsëri me humbje), ajo nuk mund të shtrihet më tej dhe të prekë rezultatin e viteve të tjera, para aplikimit të tatimit mbi fitimin.

Paragrafi 2 i nenit 27 ndalon transferimin e humbjes së shoqërive, pasi mbartja e humbjes duhet të jetë e lidhur vetëm me tatimpaguesin që e pëson atë. Meqënëse zbatimi i këtij parimi kërkon që referimi të bëhet ndaj pronarit të shoqërisë, në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose e tërthortë e kapitalit themeltar, ose të drejtave të votës të një personi ndryshon me më shumë se 50% në vlerë ose në te drejta votash, e drejta e mbartjes së humbjes në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit humbet.

3.11/1 NDRYSHIMI I PRONËSISË

Qëllimi i nenit 27/1 të ligjit është të sigurojë, në masën e mundshme, që fitimet nga shitjet /transferimet indirekte të aseteve të vlefshme, të vendosura në Shqipëri janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një shitje indirekte ndodh p.sh kur një shoqëri ka një aktiv/pasuri që një palë e tretë dëshiron të blejë. Sidoqoftë, shoqëria nuk ia shet palës së tretë aktivin, por pala e tretë blen aksionet e shoqërisë që zotëron aktivin, dhe në këtë mënyrë blen "indirekt" aktivin. Aksionet e blera mund të jenë të shoqërisë që mban aktivin ose, më shpesh, të shoqërive që kanë aksione në mënyrë direkte ose indirekte në shoqërinë që mban aktivin. Shpesh ka një numër të madh shoqërish të ndërthurura ndërmjet pasurisë dhe pronarit përfundimtar indirekt, dhe shitja mund të ndodhë në cilëndo nga lidhjet në zinxhirin e aksionerëve.

Pika 1 e nenit 27/1 të ligjit trajton personin juridik që mban aktivin, si përfitues i të ardhurave nga shitja e aksioneve/kuotave/të drejtave, të ardhura këto të barabarta me vlerën e tregut të pjesës së aktivit të trajtuar si të

transferuar. Vlera e tregut e një aktivi është ajo që pala e tretë do të marrë parasysh gjatë negocimit të kushteve të shitjes së aksioneve që shkakton ndryshimin e pronësisë. Njohja e kushteve të shitjes së aksioneve do të ndihmojë në përcaktimin e vlerës së tregut të një aktivi të trajtuar si të shitur. Gjithashtu, metoda të tjera relevante të përcaktimit të vlerës së tregut mund të përdoren. Shuma e të ardhurave të trajtuara si të marra nga shitja do të zvogëlohet më pas nga kostoja proporcionale e aktivit, duke përcaktuar fitimin ose humbjen për shitjen e vlerësuar të aktivit. Nëse ka një fitim, fitimi do të përfshihet në llogaritjen e të ardhurave të personit në vitin në të cilin ndodh transferimi i aktivit. Nëse ka një humbje, humbja do të jetë e zbritshme, por nëse kontribuon në një humbje të përgjithshme për vitin, atëherë kjo humbje mund të anulohet referuar nenit 27(2) të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Pika 1 e nenit 27/1 trajton personin juridik si riblerës të aktivit që është trajtuar si i transferuar. Në këtë mënyrë, ndërkohë që personi juridik trajtohet sikur ta transferojë aktivin, ky person mbetet përsëri zotëruesi (pronari) i aktivit. Sidoqoftë, kostoja e aktivit do të ndryshojë për shkak të transferimit dhe riblerjes së supozuar. Kostoja e re e amortizueshme e aktivit do të jetë e barabartë me të ardhurat e shitjes që personi juridik konsiderohet se do të marrë.

Për shembull, supozohet që kostoja e aktivit është 80 milionë lekë dhe vlera e tregut është 100 milionë lekë. Në një transferim që sjell një ndryshim 100% të pronësisë, personi juridik fiton 20 milionë lekë (të ardhurat nga shitja 100 milionë–80 milionë kosto e aktivit), e cila përfshihet në të ardhurat e tatueshme të personit juridik. Kostoja e asetit më pas rivlerësohet në 100 milionë lekë. Nëse aktivi është subjekt i amortizimit, ai do të llogaritet mbi koston prej 100 milionë (jo 80). Në mënyrë të ngjashme, nëse aktivi shitet më pas, atëherë vlera 100 milionë do të përdoret si kosto e aktivit për të përcaktuar nëse ka një fitim ose humbje në shitje.

Duke zgjeruar shembullin, supozojmë se ndryshimi i pronësisë së personit juridik është 60%, p.sh. pala e tretë blen vetëm 60% të aksioneve të tij. Në këtë rast vetëm 60% e një aktivi trajtohet si i shitur dhe vetëm 60% e vlerës së tregut të aktivit trajtohet si fitim i shitjes. Më tej, vetëm 60% e kostos së aktivit do t'i atribuohet transferimit. Fitimi do të jetë 12 (60%×100=60, minus 60%×80=48) dhe kjo shumë do të përfshihet në llogaritjen e të ardhurave të personit juridik. Kostoja e re e aktivit do të jetë pjesa e kostos së vjetër që i atribuohet pjesës së aktivit që nuk disponohet (80–48=32) plus të ardhurat e shitjes të trajtuara si të marra (60). Pra, nëse aktivi është një aktiv i amortizueshëm baza nga e cila do të amortizohet pas ndryshimit të pronësisë do të jetë 92 (32+60).

Pika 1 e nenit 27/1 zbatohet në të gjitha rastet nëse personi juridik është rezident ose jorezident në Shqipëri dhe nëse pasuritë i atribuohen aseteve të një selie të përhershme në Shqipëri, por me kusht që për tre vitet paraardhëse mesatarja e qarkullimit të realizuar të jetë mbi 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë. Tatimi mbi çdo fitimin që rezulton nga transferimi i aseteve aplikohet për të gjitha pasuritë pavarësisht nga vlera e tyre, pavarësisht nëse ato janë të luajtshme ose të paluajtshme dhe llojin e industrisë në të cilën përdoren.

Pika 2 e nenit 27/1, synon të parandalojë tatimin e dyfishtë. Ky paragraf pengon mundësinë e tatimit të dyfishtë duke i dhënë prioritet tatimit sipas pikës 1 të nenit 27/1. Kur një person juridik paguan tatimin mbi fitimin për shkak të një transferimi të parashikuar sipas pikës 1, atëherë shitja e aksioneve që shkaktoi ndryshimin e pronësisë (që shkakton transferimin e supozuar) është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

Për shembull, supozojmë se një shoqëri shqiptare është tërësisht në pronësi të një shoqërie të vendosur në ishujt Kajman, që është tërësisht në pronësi të një personi rezident në një vend tjetër. Shoqëria shqiptare posedon pasuri të paluajtshme me një vlerë tregu më të larte se kosto e saj. Një palë e tretë dëshiron të blejë pronën e paluajtshme, jo drejtpërsëdrejti, por duke blerë aksione në shoqërinë e ishujve Kajman. (supozohet se më shumë se 50% të vlerës së aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman i atribuohet pasurisë së paluajtshme, në Shqipëri). Pra, shoqëria shqiptare do të pësojë një ndryshim të pronësisë dhe kështu do të trajtohet si të transferojë pronën e paluajtshme për vlerën e tregut dhe pastaj do ta rimarrë pronën. Kjo do të rezultojë në një fitim që është i tatueshëm për shoqërinë shqiptare. Paragrafi 2 i nenit të ri 27/1 përjashton nga tatimi mbi fitimin shitjen e aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman, me kusht që shitja të tatohet në shoqërinë rezidente shqiptare.

Pika 3 e nenit 27/1 parashikon kërkesën për njoftim. Një person juridik që pëson një ndryshim të pronësisë duhet të njoftojë autoritetin tatimor brenda 45 ditëve nga ndryshimi. Njoftimi duhet të përmbajë detajet e ndryshimit, si palët e përfshira në transaksionet që shkaktojnë ndryshimin, si dhe marrëdhëniet e tyre me personin juridik në fjalë. Po kështu njoftimi përfshin edhe kushtet e transaksionit, përfshirë të ardhurat e shitjeve dhe mënyrën se si këto të ardhura janë llogaritur.

Pika 4 e nenit 27/1 shtrin kërkesën e njoftimit të paragrafit 3) përtej ndryshimeve të pronësisë për të cilat zbatohet rregulli i transferimit të supozuar sipas pikës 1) (ndryshim pronësie me më shumë se 20 %). Kjo është efektivisht një kërkesë njoftimi për shitjet indirekte, ato ku realizohet fitimi nga shitja e aksioneve i cili kërkohet të tatohet. Si e tillë, kërkesa për njoftim aplikohet vetëm për transferimet indirekte të pasurisë së paluajtshme.

Për shembull, supozohet se një shoqëri shqiptare është tërësisht në pronësi të një shoqërie e vendosur në ishujt Kajman, që është tërësisht në pronësi të një personi rezident në një vend tjetër. Shoqëria shqiptare posedon pasuri të

paluajtshme me një vlerë tregu më të lartë se kosto e saj. Një palë e tretë dëshiron të blejë pronën e paluajtshme të vendosur në Shqipëri, jo drejtpërsëdrejti, por duke blerë 15% të aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman. Supozojmë që më shumë se 50% e vlerës së aksioneve në shoqërinë e ishujve të Kajmanit i atribuohet pasurisë së paluajtshme të vendosur në Shqipëri, pasi neni 4, pika "e", paragrafi "ii", i ligjit trajton çdo fitim nga transferimi i aksioneve si me burim në Shqipëri.

Ndryshimi i pronësisë së shoqërisë shqiptare është më pak se 20% dhe kështu rregulli i përcaktuar në nenin 27/1(1) nuk zbatohet. Megjithatë, fitimi në dispozicion të aksioneve ka një burim në Shqipëri sipas nenit 4. Pika 4 e nenit 27/1 kërkon që shoqëria shqiptare të njoftojë autoritetin tatimor për shitjen e 15% të aksioneve në shoqërinë mëmë të ishujve Kajman. Detyrimi për njoftim nuk zbatohet nëse shitja e aksioneve rezulton në më pak se 10% ndryshim në pronësinë e shoqërisë shqiptare. Ky kufi prej 10% vendoset pasi nën këtë nivel, shoqëria shqiptare mund të mos jetë në dijeni të transaksionit të shitjes. Megjithatë, edhe pse nuk pa pasur detyrim për njoftim, nëse ndryshimi është nën 10%, shitja e aksioneve mbetet e tatueshme në Shqipëri, me kusht që aksionet të marrin më shumë se 50% të vlerës së tyre nga pasuria e paluajtshme në Shqipëri.

Pika 5 e nenit 27/1 përcakton referencën në ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon dënimin për mosrespektimin e kërkesave të njoftimit të nenit 27/1 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat.

3.12 DEKLARIMI TATIMOR DHE LLOGARITJA PERFUNDIMTARE E DETYRIMIT

Tatimpaguesi është i detyruar të dorëzojë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, formularin e deklarimit të tatimit mbi fitimin sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky formular plotësohet në përputhje me shënimet sqaruese të dhëna mbrapa tij. Po kështu, ai dorëzon në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe raportin e ekspertit të autorizuar të shoqërisë (kur ky raport kërkohet nga ligji apo aktet nënligjore).

3.13 PARAPAGIMET (PARADHËNIET)

3.13.1 Afatet e pagesë së kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin paguhet çdo tremujor ose çdo muaj në formë paradhënie gjatë vitit, bazuar në këste mujore.

Administrata tatimore, bazuar në të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës, dorëzuar nga tatimpaguesi brenda datës 31 mars të vitit vijues, llogarit kështet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për periudhën prill – dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm.

Kështet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin, për periudhën prill – dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm, i njoftohen tatimpaguesit brenda datës 30 prill të çdo viti.

Kështet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin, përcaktuar si më sipër paguhen nga tatimpaguesit në bazë tremujore ose në bazë mujore.

a) Kur kështet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin paguhen në bazë tremujore, kësti i çdo tremujori llogaritet në bazë të shumës së kësteve të çdo muaji të tremujorit. Afatet e pagesës së kësteve tremujore të paradhënieve janë:

i) për tremujorin e parë (janar-shkurt-mars) të vitit, brenda datës 30 mars;

ii) për tremujorin e dytë (prill-maj-qershor) të vitit, brenda datës 30 qershor;

iii) për tremujorin e tretë (korrik-gusht-shtator) të vitit, brenda datës 30 shtator;

iv) për tremujorin e katërt (tetor-nëntor-dhjetor) brenda datës 30 dhjetor.

b) Kur kështet e paradhënieve të tatimit mbi fitimin paguhen në bazë mujore, afati i pagesës është brenda datës 15 të çdo muaji.

3.13.2 Llogaritja e kësteve mujore të paradhënieve

a) Kur tatimpaguesi ka më shumë se dy vite që e ka filluar veprimtarinë, kështet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin llogariten si më poshtë:

Shembull:

Tatimi mbi fitimin : Viti 2014 = 1,200,000 lekë

Kështet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për vitin 2015 do të jenë:

- Për periudhën prill - dhjetor 2015 : 1,200,000/12 muaj = 100,000 lekë/muaj. Totali për 9-mujorin: 100,000 x 9 muaj = 900,000 lekë.

- Për periudhën janar - mars 2016 : 1,200,000/12 muaj = 100,000 lekë/muaj. Totali për 3-mujorin 100,000 x 3 muaj = 300,000 lekë.

- Për tremujorin e parë (janar - mars) 2015 kësti i paradhënieve presupozohet se është përcaktuar më

parë (në vitin 2014) sipas skemës së mësipërme, bazuar në deklaratën e fitimit të tatueshëm të vitit 2013.

b) Kur tatimpaguesi ka më pak se një vit që e ka filluar veprimtarinë, këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin llogariten si më poshtë:

Shembull:

Tatimi mbi fitimin : Viti 2014 = 1.350.000 lekë (tatimpaguesi e ka filluar aktivitetin më 1 prill 2014).

Këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për vitin 2015 do të jenë:

- Për periudhën janar - mars 2015: Këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin do të llogariten sipas vlerësimit të bërë nga vetë tatimpaguesi në momentin e regjistrimit, pra në datën 1 prill 2014. Në këtë datë atij i janë llogaritur këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për periudhën prill - dhjetor 2014 dhe janar - mars 2015. Supozojmë se tatimpaguesi ka vlerësuar se tatimi mbi fitimin për këtë tremujor do të jetë 300.000 lekë, pra 100.000 lekë çdo muaj.

- Për periudhën prill - dhjetor 2015 : 1,350,000 lekë/9 muaj = 150,000 lekë/muaj. Totali për 9 mujorin: 150,000 × 9 muaj = 1,350,000 lekë. Totali i kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për vitin 2015 : 300.000 lekë + 1.350.000 lekë= 1.650.000 lekë.

- Për periudhën janar-mars 2016 : 150.000 × 3 muaj = 450.000 lekë.

c) Kur tatimpaguesi e fillon veprimtarine në vitin vijues, këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin llogariten duke u bazuar në deklaratën parashikuese për shumën e vlerësuar të tatimit mbi fitimin të bërë nga vetë tatimpaguesi, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur deri në fund të vitit, pa llogaritur këtu muajin e parë të regjistrimit. Kjo formulë llogaritjeje do të shërbejë edhe për përcaktimin e kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin për 3-mujorin e parë të vitit pasardhës. Më pas, për 9-mujorin në vijim të vitit pasardhës (prill-dhjetor) këstet mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin llogariten duke pasur të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës.

Shembull:

Tatimpaguesi regjistrohet në datën 10 gusht 2014 dhe deklaron se tatimi mbi fitimin e tij për periudhën e mbetur të vitit 2014 do të jetë 800.000 lekë.

Këstet e tij mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin llogariten:

- Për secilin nga muajt e periudhës shtator-dhjetor 2014 : 800.000: 4 = 200.000 lekë/muaj

- Për secilin nga muajt e tremujorit të parë do të paguajë, gjithashtu, 200.000 lekë/muaj.

E njëjta mënyrë do të përdoret për llogaritjen e kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin në rastet kur periudhat paraardhëse kane rezultuar me humbje.

ç) Tatimpaguesit që e fillojnë veprimtarinë në vitin vijues tatimor dhe ushtrojnë aktivitet në sferën prodhuese (sipas përcaktimit të INSTAT-it për veprimtaritë prodhuese), në bazë të nenit 30 të ligjit ("Parapagimet"), nuk do të paguajnë tatim mbi fitimin në formë parapagimi për 6 muajt e parë të veprimtarisë pas regjistrimit, ose për periudhën e mbetur deri në fund të vitit vijues, nëse kjo periudhë është më e vogël se 6 muaj. Kështu, nëse një tatimpagues që zhvillon veprimtari në sferën prodhuese, regjistrohet në organin tatimor më 1 janar të vitit vijues, ai nuk do të paguajë tatim në formë paradhënie mbi fitimin për periudhën janar-qershor të vitit vijues, ndërsa për periudhën korrik-dhjetor, ai do të paguajë tatim mbi fitimin në formë parapagimi mbi bazën e deklaratës parashikuese për shumën e vlerësuar të detyrimit mujor, sipas shembujve të dhënë më sipër. Në rast se veprimtaria e këtij tatimpaguesi (regjistrimi në organin tatimor) kryhet në muajin shtator të vitit vijues, ai nuk do të paguajë tatim mbi fitimin në formë paradhënie për periudhën shtator-dhjetor të vitit vijues.

3.13.3. Korrigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin.

Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë gjatë periudhës tatimore (në çdo muaj të vitit), vërteton se tatimi mbi fitimin për periudhën vijuese do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse, organet tatimore pranojnë zvogëlimin e kësteve të paradhënieve të tatimit mbi fitimin të vendosura.

Si fakte të cilat mund të argumentojnë kërkesën për uljen e kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin mund të merren:

- Shitjet gjithsej të realizuara dhe të deklaruara nga tatimpaguesi, për muajt e kaluar të vitit vijues, në raport me shitjet gjithsej të dy viteve të mëparshme. Nëse këto shitje janë ulur në mënyrë të dukshme, administrata tatimore pranon uljen e kësteve proporcionalisht me uljen e vëllimit të shitjeve.

- Mungesa në vijim e kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin.

- Mbarimi i kontratave mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, përfundimi

i objekteve apo punëve të tjera publike të kryera.

- Fatkeqësi apo dëme të tjera që mund t'i kenë ndodhur tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në uljen e volumit të veprimtarisë së tij ekonomike.

- Mbyllja e linjave, veprimtarive të caktuara, shkurtimi i ndjeshëm i fuqisë punëtore si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.

Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit.

Shembull:

Shuma e kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin të llogaritur për t'u paguar për vitin vijues, bazuar në nenin 30 të ligjit dhe paragrafin 3.13.2 të këtij udhëzimi, është 2,100,000 lekë, i ndarë si më poshtë:

- Kështet mujore të paradhënieve të llogaritura për periudhën janar-mars 300,000 lekë (3 muaj × 100,000);

- Kështet mujore të paradhënieve të llogaritura për periudhën prill-dhjetor 1,800,000 lekë (9 × 200,000);

- Totali i kësteve mujore të paradhënieve të llogaritura për vitin : 300.000 + 1.800.000 = 2.100.000 lekë.

Tatimpaguesi, bazuar në argumentet e dhëna, ka paguar të gjitha kështet mujore të paradhënieve për periudhën janar - gusht të vitit dhe ka ulur në zero kështet mujore të paradhënieve të periudhës shtator-dhjetor për shumën 4 × 200,000 = 800,000 lekë. Pra, shuma vjetore e paguar e kësteve të paradhënieve për vitin është 1,300,000 lekë nga 2,100,000 lekë të llogaritura në fillim. Nëse sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, tatimpaguesi ka deklaruar shumën 2,200,000 lekë tatim mbi fitimin, ndryshimi kundrejt kësteve mujore të paradhënieve të paguara është më shumë se 10% (2,200,000/1,300,000 = 169 %). Në këtë rast tatimpaguesi është i detyruar të paguajë 5 për qind kamatëvonesë mbi diferencën prej 900,000 lekësh (2,200,000 - 1,300,000 lekë).

3.13.4 Korrigjimi në rritje i kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin

Brenda datës 31 tetor të çdo viti, tatimpaguesit duhet të paraqesin në administratën tatimore një deklaratë vlerësuese të tatimit mbi fitimin për vitin korrent.

Administrata tatimore mund t'i rrisë kështet mujore të parapagimeve vetëm për dy muajt e fundit të vitit tatimor vijues (nëntor - dhjetor), në rastet e mëposhtme:

a) Kur tatimpaguesi vetë konstaton se tatimi mbi fitimin, i vlerësuar prej tij për vitin vijues, do të jetë mbi 15% më i lartë se kështet mujore të paradhënieve të llogaritura sipas ligjit, ai duhet të paraqesë një deklaratë vlerësimi të tatimit mbi fitimin për vitin ushtrimor jo më vonë se data 31 tetor. Mbi këtë bazë administrata tatimore korrigjon në rritje kështet për muajt nëntor dhe dhjetor të vitit vijues.

Shembull 1:

Kështet e llogaritura për muajt janar – mars : 300,000 lekë (100,000 lekë/muaj),

Kështet e llogaritura për muajt prill – tetor : 1,400,000 lekë (200,000 lekë/muaj),

Shuma: 300,000 + 1,400,000 = 1,700,000 lekë

Kështet e llogaritura paraprakisht për muajt nëntor–dhjetor: 400,000 lekë (2x200,000),

Kështet totale për të gjithë vitin ushtrimor: 2,100,000 lekë (1,700,000+400.000),

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar nga vetë tatimpaguesi: 2,700,000 lekë,

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar nga vetë tatimpaguesi është mbi 10 për qind më i lartë se kështet mujore të paradhënieve të llogaritura (2,700,000/2,100,000 = 28%), gjë që çon në një shtesë kësti për muajt nëntor-dhjetor prej 300.000 lekë në çdo muaj (2,700,000 – 2,100,000 = 600,000/2 = 300,000 lekë/muaj).

Shembull 2:

Kështet e llogaritura për muajt janar – mars: 300,000 lekë (100,000 lekë/muaj),

Kështet e llogaritura për muajt prill – tetor: 1,400,000 lekë (200,000 lekë/muaj)

Shuma: 300,000 + 1,400,000 = 1,700,000 lekë

Kështet e llogaritura paraprakisht për muajt nëntor – dhjetor: 400,000 lekë (2x200,000)

Kështet totale për të gjithë vitin ushtrimor 2,100,000 lekë (1,700,000+400,000)

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar nga vetë tatimpaguesi: 2,300,000 lekë

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar nga vetë tatimpaguesi nuk është më shumë se 10 për qind më i lartë se kështet mujore të paradhënieve të llogaritura paraprakisht (2,300,000/2,100,000 = 9%), që do të thotë se

administrata tatimore nuk mund të bëjë rritje të kësteve mujore të paradhënieve për muajt nëntor - dhjetor. Pra, tatimpaguesi do të paguajë në ato dy muaj kështet fillestare të përcaktuara për 400,000 lekë (2x200,000).

b) Administrata tatimore mund të korrigjojë, në çdo kohë madhësinë e kështit mujor kur pas një kontrolli të thelluar të kryer për vitin tatimor paraardhës, rezulton se tatimi mbi fitimin për atë vit ka qenë i pasaktë dhe për këtë shkak për tatimpaguesin është bërë një rivlerësim tatimor. Rritja e kështit për vitin vijues do të bëhet në raport me shumën e rritur të fitimit si rezultat i kontrollit dhe i rivlerësimit përkatës.

c) Administrata tatimore mund të korrigjojë madhësinë e kështit mujor për periudhën nëntor-dhjetor, edhe kur tatimpaguesi nuk vepron në përputhje me kërkesat e përmendura në pikën "a" më sipër, pra kur nuk dorëzon një deklaratë vlerësuese të tatimit mbi fitimin për vitin vijues dhe nuk kërkon vetë rritjen e parapagesave si rezultat i vlerësimit që ai bën për rritjen e fitimit të tij me mbi 15 % në vitin vijues në krahasim me vitin paraardhës. Vlerësimi në këtë rast bëhet duke u bazuar në të gjitha informacionet që administrata tatimore ka në dispozicion, përfshirë shitjet e deklaruara, blerjet, importet, eksportet, tenderat e fituar, informacione nga bankat, furnitorët, klientët etj. Nga këto informacione, administrata tatimore duhet të krijojë bindjen se tatimi mbi fitimin i këtij tatimpaguesi në vitin vijues, do të jetë mbi 15 % më i lartë se në vitin paraardhës.

Në çdonjërin nga rastet e mësipërme, administrata tatimore njofton tatimpaguesin për rritjen e kësteve të paradhënieve, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".

3.13.5. Rillogaritja përfundimtare e tatimit mbi fitimin.

Llogaritja përfundimtare e tatimit mbi fitimin bazohet në të dhënat faktike të deklaratës së fitimit të tatueshëm dhe dokumenteve të tjera mbështetëse, si pasqyrat financiare vjetore, vlerësimet e bëra si rezultat i kontrolleve tatimore etj.

Nëse tatimi i deklaruar dhe i paguar në bazë të deklaratës vjetore të fitimit të tatueshëm është më i madh se:

- shuma e kësteve mujore të paradhënieve të paguara gjatë vitit; dhe

- tatimi i huaj i paguar, i cili kreditohet sipas nenit 37 të ligjit, tatimpaguesi paguan diferencën përkatëse, brenda datës 31 mars të vitit të ardhshëm.

Nëse tatimi i deklaruar dhe i paguar në bazë të deklaratës vjetore të fitimit të tatueshëm është më i vogël se:

- shuma e kësteve mujore të paradhënieve të paguara gjatë vitit; dhe

- tatimi i huaj i paguar, i cili kreditohet sipas nenit 37 të ligjit administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesi. Nëse tatimpaguesi nuk ka detyrime të tjera tatimore të papaguara, me miratimin me shkrim të tij, shuma e mbetur, nëse ka:

- rimbursohet automatikisht, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e deklarimit dhe e pagesës nga tatimpaguesi;

- kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

3.14 "Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifikë"

Neni 30/1 i ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" përcakton deklaratë dhe procedurë pagesash të veçantë për jorezidentët, të cilët sipas pikës 1 "ç", të nenit 16 të ligjit, janë subjekt i tatimit mbi fitimin, por për të cilët procedura e rregullt e parashikuar në nenet 29 dhe 30 nuk zbatohet. Procedura e deklarimit sipas nenit 29 të ligjit, kërkon që tatimpaguesi të përgatisë bilancin kontabël dhe deklaratën e fitimit të tatueshëm për aktivitetet që janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Dispozita e nenit 30/1 përfshin rastet kur një tatimpagues jorezident tatohet për transaksionet dhe veprimtaritë jashtë Shqipërisë, megjithëse nuk ka detyrimin për të përgatitur bilancin kontabël dhe deklaratën tatimore sipas nenit 29. Në veçanti, ky mund të jetë një rast kur një person jorezident është subjekt i tatimit për një transaksion të izoluar të realizuar p.sh në një zonë "offshore", si p.sh., shitja e aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman të trajtuara në pikën 3.11/1 të këtij udhëzimi në lidhje me pikën 4, të nenit 27/1.

Pika 1 e nenit 30/1 parashikon një deklarim të veçantë të të ardhurave të tatueshme për jorezidentët, ku një jorezident është objekt i nenit 16(1) të ligjit. Për qëllime deklarimi si më sipër do të përdoret deklarata e fitimit të tatueshëm sipas formularit "Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifikë", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Pika 2 e nenit 30/1 përjashton këtë kategori nga sistemi i kësteve tatimore dhe sistemi i kreditimit të tatimit të huaj. Tatimi për këtë kategori deklarohet dhe paguhet në të njëjtën kohë kur paraqitet deklarata e tatim fitimit.

4. Shfuqizuar.

5. TATIMI NE BURIM

5.1 MBAJTJA NE BURIM E TATIMIT MBI TE ARDHURAT

Në zbatim të nenit 33 të Ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë,

personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjerës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

5.2 Tatimi në burim nuk do të mbahet kur pagesa sipas faturës së lëshuar i bëhet:

a) Personave juridikë/fizikë tregtarë, të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, dhe kur pagesa bëhet për shërbime që përbëjnë aktivitetin normal të biznesit të tyre. Këta persona i deklarojnë këto të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit;

b) Personave juridikë/fizikë tregtarë që janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe kur pagesa bëhet për shërbime që përbëjnë aktivitetin normal të biznesit të tyre. Këta persona i deklarojnë këto të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit;

c) Çdo personi juridik shqiptar apo të huaj për pagesa që lidhen me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

d) Personave jorezidentë, në lidhje me shërbime që ata kryejnë në kuadrin e veprimtarisë së tyre biznesore për persona rezidentë shqiptarë, vetëm kur parashikohet në dispozitat e marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë që Shqipëria ka lidhur me vendin, rezident i së cilës është përfituesi i të ardhurave. Aplikimi për shmangien e Tatimit në Burim bëhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda afatit 2-vjeçar nga data e pagesës së faturës.

5.3 NIVELI I TATIMIT TE MBAJTUR NE BURIM

Tatimi në burim mbahet në masën 15% të pagesës bruto për pagesat e listuara në nenin 33 të ligjit dhe në masën 8% për dividendët dhe ndarjet e fitimit (me përjashtim të rasteve të dhëna në pikën 5.2 më lart). Për të ardhurat nga shitja e aksioneve apo kuotave të pjesëmarrjes, apo për tërheqjet (zvogëlimet) e kapitalit themeltar, ky tatim llogaritet për të ardhurat neto, në përputhje me sqarimet e bëra në këtë Udhëzim.

5.4 MBAJTJA E TATIMIT NE BURIM PER PAGESAT E KRYERA NGA JOREZIDENTET

Në zbatim të pikës 3 të nenit 33 të Ligjit, edhe personat jorezidentë mbajnë në burim tatimin për të gjitha pagesat (përcaktuar në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit) të kryera nga ana e tyre, kur këto pagesa kryhen nëpërmjet një selie të përhershme që ata kanë në Republikën e Shqipërisë, apo përfaqesuesit të emëruar prej tyre.

5.5 EVIDENTIMI I TATIMIT TE MBAJTUR NE BURIM

Tatimi i mbajtur në burim evidentohet nga personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse, si dhe nga çdo person tjetër i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, nëpërmjet regjistrimeve në librat përkatës të evidentimit, të cilët përmbajnë të dhëna të plota identifikuese për personin përfitues (përfshirë fotokopje të certifikatës së regjistrimit të përfituesit), rastet kur nuk mbahet tatim në burim në zbatim të marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë, përshkrimin e shërbimeve të marra, referencat në dokumentet që mbështesin shërbimin e marrë, shumën e pagesës dhe tatimin e mbajtur në burim.

Personi rezident, i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat sipas përcaktimeve të nenit 33, të ligjit, për çdo përfitues duhet të mbajë regjistrime për llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për të ardhurat dhe t'ia vërë ato në dispozicion administratës tatimore dhe personit përfitues të të ardhurave, për të cilin është bërë pagesa, kur një gjë e tillë kërkohet.

Personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar", deklaron dhe paguan tatimin e mbajtur në burim, në masën 15 për qind të shumave bruto të pagesave, deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës. Përjashtim nga ky rregull bën deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim për dividendët sipas përcaktimit të nenit 33/1 të ligjit, si dhe deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim për faturat e palikuiduara për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, referuar germës "ll", të nenit 21 "Shpenzime të panjohura" të ligjit. Për dividendët, deklarimi dhe pagesa e tatimit të mbajtur në burim bëhet brenda datës 20 gusht të çdo viti, pavarësisht nga koha kur do të kryhet pagesa e dividendëve për përfituesit. Për faturat e palikuiduara për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, deklarimi dhe pagesa e tatimit të mbajtur duhet të bëhet brenda datës 20 dhjetor të periudhës tatimore, pavarësisht nga koha kur do të kryhet likuidimi i tyre.

Formulari i deklarimit të tatimit të mbajtur në burim dorëzohet nga të gjithë personat e përcaktuar në nenin 33 të ligjit, të regjistruar për qëllime tatimore, përfshirë këtu të gjithë personat rezidentë në Republikën e

Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse, si dhe çdo person tjetër të njohur si të tillë nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Formulari i deklarimit të tatimit, të mbajtur në burim, është pjesë përbërëse e udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, të ndryshuar..

5.6 Vendimi për destinimin e fitimit.

Në zbatim të nenit 33/1 të ligjit, personat juridikë, subjekte të tatimit mbi fitimin, brenda datës 31 korrik të çdo viti, depozitojnë pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore (përfshirë edhe rezervat e krijuara në përputhje me statutin e shoqërisë), pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë të kapitalit dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividenti.

5.7 ZVOGËLIMET E KAPITALIT

Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve *dhe që destinohet për shpërndarje ortakëve*, do të konsiderohet divident dhe do të tatohet *si i tillë,* por vetëm në masën që zvogëlimi i kapitalit rrjedh nga fitimet e kapitalizuara të shoqërisë dhe jo nga kontributet në para ose në natyrë të pronarëve. *Shtesat* e kapitalit, kontributet në para ose në natyrë të ortakëve dhe zvogëlimi i kapitalit duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe *procedurat* e *ligjit* "Për *tregtarët dhe shoqëritë tregtare".*

5.7/1 MBAJTJA E TATIMIT NË BURIM PËR TË ARDHURAT QË REALIZOJNË INDIVIDËT NGA LOJËRAT E FATIT DHE KAZINOTË

Në zbatim të shkronjës "f" të nenit 33/1 të ligjit, organizatorët e lojërave të fatit u mbajnë tatim në burim për të ardhurat që realizojnë individët nga lojërat e fatit dhe kazinotë.

Në rastet e të ardhurave të realizuara nga pjesëmarrjet në lojërat e fatit, të tilla si: bastet, bastet on line, bingo tradicionale dhe televizive, lotari kombëtare, tatimi në burim llogaritet dhe mbahet nga organizatori i licencuar në organizimin e të tilla lojërave, mbi shumën bruto të fituar. Shuma bruto, mbi të cilin llogaritet tatimi në burim, është diferenca midis fitimit të lojtarit me shumën e paguar për biletën, ose diferenca midis fitimit të lojtarit me shumën e vënë bast.

Kazinotë dhe kazinotë elektronike

Në rastet e të ardhurave të realizuara nga pjesëmarrja në lojërat e fatit kazino dhe kazino elektronike, individi lojtar duhet të bëjë një vetëdeklarim pranë organizatorit të lojës së fatit mbi shumën e luajtur në kazino. Bazuar në këtë vetëdeklarim, organizatori llogarit tatimin në burim si diferencë midis shumës së fituar dhe shumës së luajtur nga lojtari. Organizatori nuk e pajis lojtarin me vërtetim për fitimin e shumës së parave, pa mbajtur më parë tatimin në burim.

Në rast se lojtari fiton, nga pjesëmarrjet në lojërat e fatit, një send të prekshëm, p.sh. një makinë, tatimi në burim llogaritet mbi vlerën e tregut të sendit të fituar.

Organizatori është i detyruar të mbajë tatim në burim të të ardhurave të lojtarit dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

5.8 Shfuqizuar.

6. Shfuqizuar.

7. KREDITIMI I TATIMIT TË HUAJ

7.1 Kreditimi i tatimit te paguar jashte territorit te Republikes se Shqiperise

Neni 37 (paragrafi 1 dhe 2) ka të bëjë me kreditimin e tatimit që tatimpagues rezidentë në Republikën e Shqipërisë kanë paguar në vende të tjera (jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë) për fitime që ata kanë realizuar në ato vende. Por ky reduktim nuk do të kalojë nivelin e tatimit që do të aplikohej mbi ato të ardhura sikur ato të realizoheshin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të legjislacionit fiskal shqiptar.

Shembull:

Rasti 1. Një person juridik, rezident në Shqipëri, për vitin 2018, ka aktivitet në Shqipëri, si edhe një degë në Itali, ku realizon fitim neto si më poshtë:

- nga aktiviteti në Shqipëri: 30.000.000 lekë;

- nga aktiviteti në Itali: 16.000.000 lekë.

Në bazë të dispozitave të këtij ligji (neni 17) ky person, meqenëse është rezident shqiptar, i nënshtrohet tatimit në Shqipëri mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pra detyrimi tatimor në Shqipëri do të jetë:

- fitimi në total: 46.000.000 lekë

- tatim fitimi=46.000.000 x 15% = 6.900.000 lekë

Por, për fitimin që ka realizuar në Itali tatimpaguesi është tatuar atje (si jorezident) me tarifën e tatim fitimit në Itali që është 36%. Pra, tatimi i paguar në Itali:

16.000.000 x 36%=5.760.000 lekë

Tatimpaguesi sjell dokumentacionin e plotë që vërteton pagesën e këtij tatimi në Itali. Pas kësaj, organi tatimor shqiptar bën reduktimin e tatimit si më poshtë:

- tatimi që duhej të paguhej sikur të ardhurat e realizuara në Itali të realizoheshin në Shqipëri:

16.000.000 x 15%=2.400.000 lekë. Pikërisht për këtë shumë do të bëhet reduktimi i tatimit, pra:

6.900.000 -2.400.000 = 4.500.000 lekë, që është detyrimi përfundimtar i tatim fitimit që ky subjekt do të paguajë në Shqipëri.

Rasti 2. Supozojmë se i njëjti person juridik shqiptar ka një degë për ushtrimin e aktivitetit të tij në Maqedoni, ku tarifa e tatim fitimit është 10 %. Në këtë rast do të kishim:

- fitimi i realizuar në Shqipëri: 10.000.000 lekë

- fitimi i realizuar në Maqedoni: 6.000.000 lekë

Detyrimi tatimor në bazë të nenit 17 të ligjit:

16.000.000 x 15%=2.400.000 lekë

Por, për fitimin që ka realizuar në Maqedoni, tatimpaguesi është tatuar atje me tarifën 10%. Pra tatim fitimi i paguar në Maqedoni: 6.000.000 x 10 % = 600.000 lekë. Në këtë rast, meqenëse tatimi i paguar në Maqedoni (10%) nuk e kalon tatimin e pagueshëm për ato të ardhura në Shqipëri (15%), është pikërisht kjo shumë, pra 600.000 lekë që do të reduktohet nga detyrimi tatimor në total. Në këtë rast, pasi nga tatimpaguesi të jetë marrë dokumentacioni i plotë që ka realizuar të ardhurat dhe ka paguar tatimin në Maqedoni në këtë shumë, kreditimi i tatimit do të bëhet si më poshtë:

2.400.000 -600.000=1.800.000 lekë, që është detyrimi përfundimtar i tatim fitimit që ky subjekt do të paguajë në Shqipëri.

Siç shihet, kreditimi (reduktimi) i tatim fitimit të paguar jashtë për fitime të realizuara jashtë, në asnjë rast nuk duhet të kalojë, pra mund të jetë më i vogël ose i barabartë, se tatimi që do të paguhej në Shqipëri nëse ato fitime do të realizoheshin në Shqipëri.

I njëjti parim vlen edhe për tatimin e individëve. Një individi rezident Shqiptar do t'i kreditohet tatimi mbi të ardhurat i paguar jashtë Shqipërisë për të ardhura të realizuara jashtë (përkundrejt dokumenteve vërtetuese), por jo më shumë se tatimi që do të paguhej në Shqipëri nëse ato të ardhura do të realizoheshin në Shqipëri.

Pra, gjithmonë, kreditohet (ose reduktohet) tatimi i paguar jashtë Shqipërisë për fitime ose të ardhura të realizuara jashtë Shqipërisë dhe nuk preket tatimi i të ardhurave të realizuara në Shqipëri.

7.2 KREDITIMI I HUMBJEVE

Paragrafi 3 i Nenit 37 lidhet me kreditimin (ose reduktimin) e humbjeve që një tatimpagues person juridik rezident shqiptar ka realizuar jashtë, përkundrejt fitimit që ai person ka realizuar në Shqipëri. Në këtë rast veprohet sikur neni 27 (Mbartja e Humbjeve) të zbatohej në çdo vend të huaj.

Shembull. Një person juridik rezident Shqiptar përveç aktivitetit në Shqipëri ka krijuar një degë në Itali (p.sh. aty mund të ambalazhojë produktet dhe të përfundojë kontrata shitjeje për tregun Italian), dhe, dega në Itali vitin e parë rezulton me humbje dhe vitin e dytë me fitim. Të shohim si do të bëhet kreditimi (reduktimi) i humbjes në bazë të dispozitave të paragrafit të tretë të Nenit 37:

Për vitin 2017:

- fitimi në Shqipëri: 20.000.000 lekë

- humbja e degës në Itali: 2.000.000 lekë

- fitimi nga të gjitha burimet Brenda dhe jashtë Shqipërisë (fitimi botëror ose global): 18.000.000 lekë

- tatim fitimi në Shqipëri: 18.000.000 x 15% = 2.700.000 lekë

- tatim fitimi në Itali: 0 leke

Për vitin 2018:

- fitimi në Shqipëri: 20.000.000 lekë

- fitimi në Itali: 16.000.000 lekë

- fitimi nga të gjitha burimet Brenda dhe jashtë Shqipërisë (fitimi botëror): 36.000.000 lekë

- tatim fitimi në Shqipëri si rezident (neni 17) i llogaritur për fitimin global:

36.000.000 x 15% =

5.400.000 lekë

- tatim fitimi në Itali:

16.000.000 x 36% =

5.760.000 lekë

Kreditimi (reduktimi) i tatimit të paguar në Itali do të bëhet në mënyrën dhe në masën që vijon:

Nga fitimi i vitit 2018 i degës në Itali mbartet (zbritet) humbja e vitit të mëparshëm 16.000.000 – 2.000.000 = 14.000.000 lekë (sipas nenit 27). Për këtë shumë llogaritet tatimi sikur ky fitim të ishte realizuar në Shqipëri (sipas paragrafëve 1 dhe 2, të nenit 37), pra 14.000.000 x 15% = 2.100.000. Është pikërisht kjo shumë që do të reduktohet nga detyrimi tatimor global. Pra detyrimi tatimor përfundimtar për tatimin mbi fitimin që do të paguajë personi juridik në Shqipëri për vitin 2018, është: 5.400.000 – 2.100.000 = 3.300.000 lekë.

8. DISPOZITA KALIMTARE

Në zbatim të këtij neni, tatimpaguesit që përfitonin lehtësitë tatimore, sipas nenit 6 të ligjit nr. 7677, datë 03.03.1993 "Për tatimin mbi fitimin" do të vazhdojnë t'i gëzojnë ato në përputhje me dispozitat e atij ligji. Ndërsa subjektet e krijuar mbas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, nuk përfitojnë më lehtësi tatimore.

Gjithashtu, do të gëzojnë lehtësitë tatimore dhe përjashtimet, të gjithë tatimpaguesit e parashikuar në Ligjet: nr. 7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin"; nr 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe me Dekretin nr. 782, datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve".

9. Shfuqizime

Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 5, datë 18.01.2005 shfuqizohet.

10. Bashkëngjitur janë:

1. Tabela nr.1 "Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi";

2. Tabela nr.2 "Tatimi mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluejtshme";

3. Formulari i Deklarimit dhe Pagesës të Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, E-TAP 010/a;

4. Formularit i deklarimit të të ardhurave personale nga burime të tjera (jo nga mardhënjet e punësimit aktual) E-TAP 013/a;

5. Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin E-TAF 001/A;

6. Deklarata Analitike e Tatimit mbi të Ardhurat E-TAF 000/a;

7. Formulari "Kërkesë për Regjistrim" Form 1.1;

8. Formulari "Njoftim i Ndryshimeve në Regjistrim" Form 4.1;

9. Model Urdhër Pagese për Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin E-TBV-020/a;

10. Modeli i Librit të Blerjes për Tatimpaguesit e Biznesit të Vogël E-TBV-010;

11. Modeli i Librit të Shitjeve (Qarkullimit) për Tatimpaguesit e Biznesit të Vogël, E-TBV-011;

12. Modeli i Faturës së Thjeshtë Tatimore, E-TBV-055/a;

13. Modeli i Dëftesës Tatimore, E-TBV-013;

14. Formulari "Deklarata Parashikuese e Qarkullimit të Biznesit të Vogël" E-TBV-014.

15. Formulari i deklarimit dhe pageses se tatimit te thjeshtuar mbi fitimin. FDP-SPT 001.[2]

11. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

---

[2]Me udhëzimin nr. 13, datë 26.5.2011:
Në deklaratën individuale vjetore për individët e huaj, te pjesa "Për mënyrën e plotësimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të individëve të huaj në Republikën e Shqipërisë, pika 23 ndryshohet, me përmbajtjen:
"23. Tatimi mbi pagën plotësohet për shumën e tatimit mbi pagën dhe shpërblimet mbi pagën të paguar gjatë periudhës tatimore. Në rastin e të vetëpunësuarit që kryen veprimtari të biznesit të vogël, kjo kuti plotësohet me shumën e tatimit të paguar nga zhvillimi i kësaj veprimtarie (kutia nr.22 e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël)."

Pasqyra nr. 1

TABELA E TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

(ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 30.7.2013; nr. 4, datë 21.2.2019)

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		**Përqindje**
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30.000	Zero për qind
30.001	150 000	+13 për qind të shumës mbi 30 000 lekë.
150 001	Më tepër	15 600 lekë + 23 për qind të shumës mbi 150 000 lekë

FORMULAR DEKLARIMI DHE PAGESE NGA PERSONA JOREZIDENTE SPECIFIKE
(FORM ON DECLARATION AND PAYMENT BY CERTAIN NON-RESIDENTS)
Periudha fiskale për të cilën plotësohet ky formular fillon më 01/01/ 20----deri 31/12/20----
(The fiscal period on which is filled this form begins from 01/01/ 20---- to 31/12/20__)

Shënim. Janë subjekt i plotësimit të këtij formulari vetëm tatimpaguesit jorezidentë të cilët janë të detyruar të deklarojnë dhe paguajnë atim mbi fitimin nga shitja e aksioneve/drejtave sipas nenit 30/1 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar
Note: Are subject of filing this form only the nonresident taxpayers which are obliged to declare and pay tax on profits from the disposal of shares/rights, according to the article 30/1 of the Law "On Income tax", as changed.

Pjesa e I-rë. Informacion mbi tatimpaguesin raportues jorezident
(Part I - Information on nonresident reporting taxpayer)
1. Emri i tatimpaguesit joresident
Name of nonresident taxpayer……
2. Vendi i krijimit
Country of incorporation……
3. Rezidenca tatimore
Tax residence……..
4. Adresa
Address……
5. Personi i kontaktit
Contact person……
6. Numri i telefonit & e-mail
Telephone number, e-mail ……
7. Jepni një përshkrim të shkurtër të aktivitetit(ve) të biznesit
Provide brief description of business acitivity(s)……

Pjesa e II-të. Informacion mbi deklarimin dhe pagesën.
(Part II. Information on declaration and payment).
1. % e pronësisë tek personi juridik resident shqiptar
% ownership in Albanian resident juridical person……
2.% e aksioneve/të drejtave të transferuara
% of shares/rights disposed……
3.Fitimet nga transferimi i aksioneve të drejtave
profits from the shares/rights disposed……
4. tatimi mbi fitimet e realizuara 15%
Tax on profits from the disposal of shares/rights 15%……
5. Shuma për t'u paguar
Amount to be paid……

Pagesa bëhet në një llogari bankare të vecantë të administratës tatimore
Payment to be made in a specific bank account of tax administration

Pjesa III Certifikim mbi saktësinë.
(Certification on the accuracy).

Unë vërtetoj se informacioni i dhënë në këtë deklarim dhe në çdo dokumentacion që i bashkëngjitet atij është i njohur nga ana ime, është përgatitur në mirëbesim, bazuar në informacionin dhe evidencë më të mirë të disponuar.
I certify that the information given in this form and in any documents attached is prepared in good faith, based on the best information and evidence possessed.

Emri dhe mbiemri i administratorit/drejtorit
Name and surname of Administrator/Director

Vënshkrimi /Signature

Tabela nr. 2

Tatimi i të ardhurave nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme
(shfuqizuar me udhëzimin nr. 10, datë 25.2.2013)

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT MBI TE ARDHURAT NGA PUNESIMI

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD) (Vetem per perdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):	(3)_____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:	(4)_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5)_____
Adresa:	(6)_____
Qyteti/Komuna/Rrethi:	_____
Numri Telefonit:	(7)_____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

(8) ☐ Pa veprimtari

Deklarim permbledhes

(9) Te ardhurat e tatueshme (9)

(10) Tatimi per tu paguar (10)

(11) Numri gjithsej i personave per te cilet eshte mbajtur tatim (11)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

Vetem per perdorim zyrtar

☐ Leke
☐ Xhirim
☐ Cek
☐ Te tjera:.....

PAGESA

SHUMA E PAGUAR:

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te bankes

Origjinali - Zyra e Tatimeve
Kopja -Personi i Tatueshem

Numri i Formularit E-TAP 010/a

Shenimet e Formularit E-TAP 010/a

Shenim 1:	*Periudha Tatimore.* Shenohet periudha tatimore ne formatin VVVVMM p.sh. 200509
Shenim 2:	*Numri Serial.* Kjo rubrike perdoret nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.
Shenim 3–7:	*Kutiza 3 — 7 Gjeneralitete.* Shenoni te dhenat e subjektit siç paraqiten ne formular dhe tregoni nese te dhenat e paraqitura nuk jane te plota ose kane ndryshuar.
Shënim 8:	*Persona juridike, si dhe persona fizike me punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes) te regjistruar si tatimpagues ne TVSH, apo ne Biznesin e Vogel:* Nese per periudhen e deklarimit nuk egziston Tatim mbi te Ardhurat nga Punesimi per t'u paguar, spontoni kutizen nr.8. Nuk eshte e nevojshme te plotesoni ndonje kuti tjeter. Dorezojeni formularin, brenda dates se caktuar , ne banke ose poste (sipas percaktimit nga organet tatimore).
Shënim 9:	*Persona juridike, si dhe persona fizike me punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes) te regjistruar si tatimpagues ne TVSH, apo ne Biznesin e Vogel :* Shënoni ne kutizen nr. 9 shumen e te gjithe pagave te tatueshme qe i keni dhene punemarresve (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter), që e gjeni ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a
Shënim 10:	Ne kutizen nr.10, shenoni shumen gjithsej te Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi të mbajtur nga punëmarrësit e personit juridik dhe fizik (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter) që e gjeni ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a, dhe paguani shumën e duhur në bankë ose poste (sipas percaktimit nga organet tatimore), brenda dates se caktuar
Shenim 11	Ne kutizen nr.11, shenoni numurin gjithsej te punëmarrësve te personit juridik dhe fizik (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter) per te cilet eshte mbajtur Tatim mbi te ardhurat nga punesimi, që e gjeni ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a,
Shenim 12 **Personat Juridike e fizike te regjistruar ne TVSH ose dhe ne Biznesin e Vogel :**	<u>*Person regjistruar ne TVSH (Biznes i Madh) apo ne Biznes te Vogel:*</u> Plotesoni kutizat 9-10-11 me te dhena per gjithe punemarresit (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter) dhe me pas dergojeni kete formular ne banke ose ne poste (sipas percaktimit nga organet tatimore) me pagesen per t'u kryer. *a) Person i regjistruar ne TVSH (Biznes i Madh)* Formularin dorezojeni **brenda dates 20 te muajit ne vijim** te muajit te deklarimit, *b) Person I regjistruar ne Biznes te Vogel* Formularin dorezojeni **brenda dates 20 te muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori** te vitit kalendarik, **me te dhena mbi baze tremujori,** **Neqoftese kini statusin dhe punoni si I vetepunesuar i vetem pa punemarres apo si I vetepunesuar me punonjes te papaguar te familjes, nuk kini detyrim te paguani dhe deklaroni Tatim mbi te Ardhurat nga Punesimi.** **Sa herë** që ju edhe brenda të njëjtës periudhë tatimore (tremujori), **ndryshoni statusin,** nga "I vetëpunësuar i vetëm" dhe "I vetëpunësuar pa punëmarrës, me punonjës të papaguar të familjes" në statusin "I vetëpunësuar me punëmarrës" dhe "I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes", **perpara ndryshimit te statusit jeni i detyruar te paraqiteni ne degen e tatimeve per te deklaruar ndryshimin** dhe per te plotesuar formularin e ndryshimeve ne regjistrim.
Shenim 13	Te dhenat e ketij formulari nxirren dhe **jane te barabarta me te dhenat e formularit** "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a, per periudhen tatimore korensponduese.
Shenim 14	**Per dorezimin me vonese te formularit ose per pagese te vonuar, zbatohen Interesa e Gjoba sipas ligjit.**

DEKLARATE E TATIMIT MBI TE ARDHURAT NGA BURIME TE TJERA

Perfituesi i te Ardhurave	Paguesi i të Ardhurave
Emri Mbiemri [1]_____	Emri Mbiemri [3] _____
Adresa e Banimit [2] _____	_____
	Adresa [4] _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time se të ardhurat që kam përfituar, mbi bazën e të cilave do të llogaritet dhe derdhet tatimi mbi të ardhurat personale në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" janë:

Të ardhurat nga dhënia me qera		10 %	
Të ardhurat nga huatë		10 %	
Të ardhura nga pronësia intelektuale dhe të drejtat e autorit		10 %	
Të ardhurat me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë		10 %	
Të ardhuara të tjera		10 %	
SHUMA E TË ARDHURHURAVE QË DEKLAROHEN			

Shenim: Ne kete deklarate nuk perfshihen te ardhurat personale te realizuara, per te cilat tatimi eshte mbajtur ne burim sipas nenit 33 dhe paragrafit te pare te nenit 10 (te ardhura nga punesimi) te ligjit te cituar me siper.

DEKLARUESI

Data e Deklarimit: _____

_____

(emri, mbiemri, nenshkrimi)

(Zëvendësuar me udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2014; zëvendësuar me udhëzimin nr. 12, datë 15.3.2019)

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD) (Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore	(1) Numri Serial:_____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshëm (NIPT): **(3)** _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshëm: **(4)** _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: **(5)** _____
Adresa: **(6)** _____
Qyteti/Komuna/Rrethi :
Numri Telefonit: **(7)** _____

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plote ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet	**Te ushtrimit**	**Tatimore**
(8/9) Te ardhurat	*(8)*	*(9)*
(10/11) Shpenzimet	*(10)*	*(11)*
(12) Shpenzimet e pazbritshme		*(12)*
Rezultati		
(13/14) Humbja	*(13)*	*(14)*
(15/16) Fitimi	*(15)*	*(16)*
(17) Humbje e mbartur		*(17)*
(18) Fitimi i tatueshëm neto (16-17)		*(18)*

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 15 %	*(19)*
(20) Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%	*(20)*
(21) Tatim fitimi me përqindje të tjera	*(21)*
(22) Tatim fitimi (19+20+21)	*(22)*
(23) Tatim fitimi i shtyre	*(23)*
(24) Tatim Fitimi i detyrueshëm për t'u paguar	*(24)*

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT

A. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. **Numri serial** gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata
2. **Periudha Tatimore** është vjetore
3. **Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT)** është numri i dhënë nga QKR dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve
4. **Emri Tregtar i Personit te Tatueshëm** është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it
5. **Emri, Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar
6. **Adresa** tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT - it
7. **Numri i Telefonit** (nqs ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike

B. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

i. Llogaritja e rezultatit

8. **Të ardhurat e ushtrimit** janë të ardhurat totale të periudhës ushtrimore
9. **Të ardhurat tatimore** janë të ardhurat që i përkasin aktivitetit të tatueshëm
10. **Shpenzimet e ushtrimit** janë shpenzimet totale të periudhës ushtrimore
11. **Shpenzimet tatimore** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm
12. **Shpenzimet e pazbritshme** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që nuk njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm

ii. Rezultati

13. **Humbja e ushtrimit** është diferenca e shpenzimeve të ushtrimit (kutia 10) me të ardhurat e ushtrimit (kutia 8) në rast se shpenzimet e ushtrimit janë më të mëdha se të ardhurat e ushtrimit
14. **Humbja tatimore** është diferenca e shpenzimeve tatimore (kutia 11) pasi të zbriten shpenzimet e pazbritshme (kutia12), me të ardhurat tatimore (kutia 9) në rast se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme janë më të mëdha se të ardhurat tatimore
15. **Fitimi i ushtrimit** është diferenca e të ardhurave të ushtrimit (kutia 8) me shpenzimet e ushtrimit (kutia 10) në rast se të ardhurat e ushtrimit janë më të mëdha se shpenzimet e ushtrimit
16. **Fitimi tatimor** është diferenca e të ardhurave tatimore (kutia 9), me shpenzimet tatimore (kutia 11) pasi janë zbritur nga këto të fundit shpenzimet e pazbritshme në rast se të ardhurat tatimore janë më të mëdha se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme.
17. **Humbje e mbartur** është humbja e mbartur nga periudhat paraardhëse dhe që njihet për efekte tatimore për t'u mbuluar nga fitimet e periudhës që deklarohet.
18. **Fitimi i Tatueshëm neto** është fitimi që mbetet nga fitimi tatimor (kutia 16) pasi zbritet humbja e mbartur (kutia 17)

iii. Llogaritja e tatim fitimit

Shënim : Nëse zbatoni dy ose më shumë shkallë tatimore dhe duhet të ndryshoni vlerën e kutive 19, 20, 21, vlerë e cila është e parallogaritur me shkallën tatimore standarte 15 %, atëherë duhet të klikoni kutinë në deklaratë " ■ shënoje këtë kuti për të ndryshuar vlerën e shumës"

19. **Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 15 %** është vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor përkatës, në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar)
20. **Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%** është vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor përkatës, në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar)
21. **Tatim fitimi me përqindje të tjera** është shuma e tatimeve të llogaritura me përqindje të tjera (nëse ka) ndaj fitimit të tatueshëm neto sipas ligjeve të tjera të veçanta
22. **Tatim fitimi** është shuma e tatimit të llogaritur me shkallën tatimore standarde 15 % (kutia 19), shuma e tatimit të llogaritur me shkallën tatimore standarde 5% (kutia 20) dhe me Tatim fitimin me përqindje të tjera (kutia 21)
23. **Tatim fitimi i shtyrë** është shuma e llogaritur e tatim fitimit, e cila për shkak të lehtësive tatimore (nëse ka) nuk duhet të paguhet në organet tatimore, por vetëm të rezervohet dhe të paguhet në rast të thyerjes së kushtit për të cilin është përfituar lehtësia tatimore)
24. **Tatim fitimi i detyrueshëm për t'u paguar** është shuma e tatim fitimit t'u detyrueshëm për tu paguar

(Zëvendësuar me udhëzimin nr. 31, datë 29.12.2014)

DEKLARATA INDIVIDUALE VJETORE E TË ARDHURAVE

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD) (Vetëm për përdorim zyrtar)
_____

(2) Periudha tatimore (viti)	

(1) Numri Serial: _____

Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit ☐ KORRIGJUESE

SEKSIONI A : TË DHËNA IDENTIFIKUESE

[3] REZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ☐

[4] JOREZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ☐

TË DHËNA IDENTIFIKUESE PËR INDIVIDIN

(5) Emri_____, Atësia_____; Mbiemri_____, Seksi: M ☐ F ☐

(6) Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit _____

(7) Adresa kryesore: _____

(8) Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

(9) Statusi i Deklaruesit I/E martuar ☐ I/E martuar me fëmijë ☐ Beqar/e ☐ I/E ve ☐ I/E divorcuar ☐ Kryefamiljar/e ☐

TË DHËNA PLOTËSUESE PËR INDIVIDIN

(10) Telefoni_____, Cel._____, E-mail_____

(11) Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore: a) Në pronësi ☐ b) Me qira ☐ c) Falas nga pronari ☐ d) Te tjere ☐

(12) Emër/Mbiemër i pronarit _____, Adresa_____

ADRESA E BANIMIT NËSE ËSHTË E NDRYSHME NGA ADRESA E TË DHËNAVE IDENTIFIKUESE

(13) Adresa_____

(14) Nr. Tel:_____, Cel_____, E-mail_____

(15) Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton : a) Në pronësi ☐ b) Me qira ☐ c) Falas nga pronari ☐ d) Të tjera ☐

(16) Emri /Mbiemri i pronarit _____Adresa_____

PERSONA NË KUJDESTARINË E DEKLARUESIT

(17) Persona nën kujdestarinë e deklaruesit gjithsej ☐ Numri i personave brenda familjes në kujdestari ☐ Të tjerë persona në kujdestari ☐

Personi Deklarues
(Emri/Mbiemri) _____ **Data e deklarimit** ____/____/_____

Firma _____

(2) Periudha tatimore (viti) _____

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO		
[3]	Të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit ……..	[3]
[4]	Tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet e punësimit……..	[4]
[5]	Të ardhurat bruto nga dividenti	[5]
[6]	Të ardhurat bruto nga qiraja……..	[6]
[7]	Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit……	[7]
[8]	Të ardhurat bruto nga interesat bankare…….....	[8]
[9]	Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme……	[9]
[10]	Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit……..	[10]
[11]	Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, liçensa, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbehen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike……	[11]
[12]	Fitime kapitali nga dhurimi……..	[12]
[13]	Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë……	[13]
[14]	Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart ……..	[14]
[15]	**SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO (Kutia 3 + kutia 5 deri 14)**……..	[15]
SHPENZIME TË ZBRITSHME		
[16]	Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim ……	[16]
[17]	Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe për personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor……	[17]
[18]	**SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME (kutia 16 deri 17)** …….	[18]
	TATIMI I LLOGARITUR PER T'U PAGUAR	
[19]	Të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi minus shpenzimet e zbritshme (vetem kur kutia 15 < 1 050 000) (kutia 15 – kutia 3 – kutia 18) ……	[19]
[20]	Tatimi llogaritur për të ardhurat e tatueshme pa të ardhurat nga punësimi (kutia 19 x 15%)....	[20]
[21]	**SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR (kutia 4 + kutia 20)**	[21]
	TATIMET E PAGUARA GJATE PERIUDHES TATIMORE	
[22]	Tatimi mbi të ardhurat bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit……	[22]
[23]	Tatimi mbi dividentin……..	[23]
[24]	Tatimi mbi qiranë……..	[24]
[25]	Tatimi mbi fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme…..	[25
[26]	Tatimi mbi interest bankare……..	[26]
[27]	Tatimet mbi fitimet kapitale të krijuara nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme…	[27]
[28]	Tatimi mbi fitimet në nga lotaritë apo lojrat e tjera të fatit……	[28]
[29]	Tatimi mbi të ardhurat bruto nga të ardhurat e rubrikës [11……	[29]
[30]	Tatimi mga të ardhurat nga fitimet kapitale nga dhurimi……	[30]
[31]	Tatimi mbi të ardhura të tjera……	[31]
[32]	Tatimi mbi të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë…….	[32]

[33]	**Kreditimi i tatimit të huaj**.....	[33]
[34]	**SHUMA E TATIMIT TE PAGUAR (kutia 22 deri kutia 31 plus kutia 33)**.....	[34]
[35]	**TATIMI I DETYRUAR PER T'U PAGUAR (kutia 21-kutia 34)**.....	[35]
[36]	**TATIMI I PAGUAR TEPER (kutia 34-kutia 21)**.....	[36]

Personi Deklarues
(Emri/Mbiemri) _____

Firma _____

Data e deklarimit _____/_____/_____

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATËS INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

1. Numri serial përdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore (organi tatimor)dhe shërben për të azhornuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.
2. Periudha Tatimore është periudha që përfshin deklarimin nga data 1 Janar deri në 31 Dhjetor të vitit raportues.

SEKSIONI A : TE DHENA IDENTIFIKUESE
Të dhëna identifikuese për individin.
3. Rezident në Republikën e Shqipërisë. Plotesohet duke vendosur shenjën "X" në kutinë nëse individi është rezident në Republikën e Shqipërisë.
4. Jo-Rezident në Republikën e Shqipërisë. Plotesohet duke vendosur shenjën "X" në kutinë nëse individi nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë.
5. Emri, Atësia, Mbiemri, Seksi, plotësohet me të dhënat e individit i cili deklaron me anë të kësaj deklarate, me gërma kapitale.
6. Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në dokumentin e letërnjoftim ID-së (në kartën e identitetit).
7. Adresa kryesore plotësohet për adresën që deklaruesi ka sipas të dhënave në regjistrin e gjëndjes civile.
8. Qyteti/Komuna/Rrethi plotësohet sipas regjistrit të gjendjes civile.
9. Statusi i Deklaruesit plotësohet duke vendosur shenjën "X" brënda kutive.

Të dhëna plotësuese për individin
10. Telefon, Celular, E-mail, plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e_mailit, që disponon deklaruesi.
11. Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore plotësohet duke vendosur shenjën "X" nëse banesa është në pronësi të deklaruesit me dokumenta ipoteke, marrë me qira apo është dhënë falas në përdorim dhe të tjerë.
12. Emër/Mbiemër i pronarit, Adresa plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ja ka lënë në përdorim falas, e të tjerë.
Adresa e banimit nëse është e ndryshme nga adresa e të dhënave identifikuese.
13. Adresa e banimit të deklaruesit nëse ka ndryshuar nga adresa e deklaruar në të dhënat identifikuese.
14.Numri i telefonit, Celulari, E-mail, plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mailit nëse ka ndryshuar, nga të dhënat identifikuese.
15. Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton, plotësohet duke vendosur shenjën "X" nëse banesa është në pronësi të deklaruesit, marrë me qira apo është dhënë falas.
16. Emër/Mbiemër i pronarit, Adresa plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ia ka lënë në përdorim falas.
17. Persona nën kujdestarinë e deklaruesit, plotësohet nga kryefamiljari apo bashkëshortja kur kjo është kryefamiljare duke vënë në kuti, numrin e personave brenda familjes në kujdestari dhe numrin e të tjerë personave në kutinë tjetër.

SEKSIONI B : TË DHËNA PER LLOGARITJEN E TATIMIT TË ARDHURAT BRUTO
3. Të ardhurat bruto nga pagat apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, plotësohet për totalin e pagave dhe shpërblimeve që deklaruesi përfiton nga të gjitha marrëdhëniet e punësimit gjatë periudhës tatimore.
4. Tatimi i llogaritur mbi pagat dhe shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, do të jetë fushë e lirë dhe do të plotësohet nga vetë deklaruesi. Shuma e tatimit të vendosur në këtë kuti, në asnjë rast nuk mund të jetë më e vogël se tatimi i mbajtur në burim dhe i paguar nga punëdhënësi për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës gjatë vitit. Kjo fushë do të plotësohet nga individi deklarues, i cili do të llogarisë tatimin mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet për të gjitha të ardhurat që përfitohen gjatë muajit, edhe kur ai i përfiton ato nga punëdhënës të ndryshëm. Në rastin kur shuma e të ardhurave të përfituara gjatë muajit nga dy apo më shumë punëdhënës e kalojnë vlerën që tatohet me zero përqind (30,000 lekë), tatimi do të llogaritet mbi totalin e të ardhurave mujore (totali i të ardhurave nga të gjithë punëdhënësit). Tatimi i llogaritur në këtë mënyrë për çdo muaj të vitit, mblidhet për 12 muajt e vitit dhe hidhet në një shumë të vetme në këtë fushë, e cila përfaqëson tatimin vjetor të llogaritur për pagat dhe shpërblimet. Në rast se shuma e të ardhurave të përfituara gjatë një muaji nga një apo më shumë punëdhënës është nën kufirin e tatueshëm (30,000 lekë), kjo fushë do të jetë zero.
5. Të ardhurat bruto nga dividenti për pjesëmarrje në shoqëritë tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit, do të plotësohet për shumën e dividentit që individi deklarues përfiton nga të gjitha pjesmarrjet e tij në shoqëritë tregtare, apo veprimtaritë e biznesit.
6. Të ardhurat bruto nga qiratë, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto që individi realizon nga dhënia me qira e një ose disa objekteve.
7. Fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtëshme në pronësi të individit deklarues, do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga individi deklarues nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme gjatë periudhës tatimore.
8. Të ardhurat bruto nga interesat bankare, do të plotësohen për totalin e të ardhurave nga interesat bankare që individi deklarues ka përfituar, gjatë periudhës tatimore.
9. Fitimi kapital neto i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtëshme, do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga investimet në tituj, shitje aksionesh, e pasuri të paluajtëshme, duke përjashtuar të ardhurat që janë pasqyruar në kutinë 7. Me termin "fitim kapital i realizuar" kuptohet diferenca ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë.
10. Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit, do të plotësohet për totalin e shumave bruto të fituara nga lotaritë apo lojra të tjera të fatit.
11. Të ardhura bruto nga pasuri intelektuale licënsa, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto nga të gjitha, sa përshkruar më sipër.
12. Fitimet kapitale nga dhurimi, do të plotësohet për shumën e fitimeve kapitale të realizuara nga dhurimi.
13. Të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të realizuar nga individi deklarues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
14. Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të tjera, të cilat nuk janë të përfshira në të ardhurat e sipërshënuara.
15. SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO plotësohet për shumën totale të të ardhurave të deklaruara nga individi nga kutia 3 deri në kutinë 14 pa përfshirë shumën në kutinë 4 (kutia 3 + kutia 5 deri kutia 14).

SHPENZIME TË ZBRITËSHME
16. Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, do të plotësohet për shumën e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim nga banka brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
17. Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, do të plotësohet mbështetur në faturat e lëshuara nga institucionet shëndetësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për justifikimin e shpenzimeve për mjekim,sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.
18. SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITËSHME, plotësohet për totalin e shpenzimeve nga kutia 16-17.

TATIMI I LLOGARITUR PËR T'U PAGUAR
19. **Të ardhura të tatueshme përveç të ardhurave nga punësimi minus shpenzimet e zbritshme**, plotësohet për diferencën ndërmjet shumës totale të të ardhurave bruto të tatueshme (kutia 15) minus të ardhurat bruto të tatueshme nga pagat në lidhje me marrëdhëniet e punësimit (kutia 3) minus shumën e shpenzimeve te zbritshme (kutia 18). Përfitojnë shpenzime të zbritshme të gjithë individët, të cilët kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit.
20. Tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme përveç të ardhurave nga punësimi, plotësohet për shumën e tatimit të llogaritur që rezulton nga kutia 19 shumezuar me 15 perqind (kutia 19 x 15 %)
21. SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR, plotësohet për shumën e tatimit të llogaritur që rezulton nga mbledhja e tatimit të llogaritur nga individi deklarues mbi pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punësimit (kutia 4) me shumën e tatimit të llogaritur për të gjitha të ardhurat e tjera të tatueshme (kuti 21) (kutia 4 + kutia 200.

TATIMET E PAGUARA GJATE PERIUDHES TATIMORE

Kutia 22 Tatimi mbi të ardhurat bruto nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punësimit, plotësohet me shumën e tatimit të paguar nga punëdhënësi/punëdhënësat për pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punës.
Kutitë 23 deri kutia 31 plotësohen me shumat e tatimit të paguar për të ardhurat e përfituara nga të gjitha burimet nga individi deklarues, përveç të ardhurave nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet e punës.
